



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional  
në:  
“Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi”  
“Universiteti i Sporteve të Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Genci Burazeri

GENC BURAZERI

Prof. As. Dr. Irena Kola

Mars/2020

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

GENC BURAZERI

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL” NË “AKTIVITETI FIZIK DHE REKREACIONI - TRAJNER FITNESI”, NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Master Profesional në “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi” është hapur në vitin akademik 2014–2015. Ky program studimi ofrohet në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, që u hap me Urdhër Nr. 51, datë 05.02.2015, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 5, datë 05.01.2015

Programi i studimit Master Profesional në “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi” synon [cit]: *përgatitjen e specialistëve me njohuri të përgjithshme në fushën e aktivitetit fizik (trajnerit personal) dhe rekreacionit, në drejtimin e menaxhimit individual dhe në grup si dhe të njohë dhe të përdorë teknologjinë e aplikuar në praktikën e stërvitjes, rehabilitimit dhe rekreacionit nëpërmjet lëvizjes.*

Programi i studimit realizohet me 60 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e “Ciklit të Dytë” Master Profesional në “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi” .

Programi i studimit MP në “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi” krahas formimit specifik në fushën e aktivitetit fizik dhe rekreacionit, ofron edhe formim të përgjithshëm metodologjik e kulturor të studentëve, për të formuar kështu krahas specialistit të aktivitetit fizik e rekreacionit edhe qytetarin. Kështu, studentët marrin një formim bazë në lidhje me aspekte akademike e metodologjike, por edhe elementë të kulturës së përgjithshme (përmes lëndëve si histori, sociologji, menaxhim, terminologji-gjuhë e huaj, etj).

Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të japë jo vetëm njohuri teorike, por edhe aftësi praktike. Të kombinuara së bashku këto dimensione e pajisin studentin në Master Profesional me njohuri të përgjithshme dhe disa aftësi bazë në lidhje me punën apo specializimin e mëvonshëm si specialist në aktivitet fizik dhe rekreacioni.

Gjithashtu programi i studimit MP në “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi” bën të mundur përgatitjen e studentëve në mënyrë cilësore të cilët behen profesionistë të fushave të: Fitnesit, Turizmit dhe Aventurës, Aktiviteteve Rekreative, të diplomuar të mund të punësohen jo vetëm në vendin tonë, por lehtësisht edhe jashtë vendit, kjo për shkak se kjo diplomë është pothuajse e unifikuar me diplomat në disa vende Europiane.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM:

Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën një Grup ekspertësh: Prof.Asoc. Irena KOLA dhe Prof. Dr. Genci BYRAZERI, si ekspertë të jashtëm të vlerësimit për këtë program studimi.

Në përzgjedhjen e anëtarëve të Grupit është mbajtur parasysh kompetenca profesionale, përvoja mësimdhënëse, aftësitë analizuese, për përpunimin e informacionit për të kryer një vlerësim të paanshëm, shkalla e nevojshme të njohjes së institucionit, si dhe profili individual profesional.

Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Në ditët e vizitave në institucion u planifikua më parë një radhë pune si: konsultim me personelin akademik dhe studentët, me anëtarët e GVB, sekretarinë etj.

GVJ është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UST-së. Grupit i janë vënë në dispozicion çdo lloj dokumentacioni i kërkuar dhe ka shfrytëzuar për këtë vlerësim në mënyrë racionale të dhënat që nevojiten për të bërë të mundur procesin e vlerësimit të jashtëm.

Ecuria e procesit të vlerësimit të jashtëm është ndjekur dhe mbikqyrur nga koordinatori teknik Renata QATIPI, si përfaqësuese e ASCAL, e cila ka koordinuar procesin e mbledhjes së të dhënave. GVJ-ja ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces. Gjatë takimit u miratua plani i punës, hapat dhe afatet deri në dorëzimin e draftit përfundimtar të raportit të vlerësimit të jashtëm.

Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është ME. Renata Qatipi.

Më datë 24.03.2020, përmes sistemit AMS, Universiteti i Sporteve të Tiranës është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm. Me datë 25 Mars 2020 UST përcjell nëpërmjet AMS komentimin që “jemi plotësisht dakort me të gjitha definicionet e cituara nga ana e GVJ”.

Në këtë rast Draft Raporti kthehet ne Raport përfundimtar.

**Shënim:** Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë e kushteve të jashtëzakonshme pas tërmetit të 26 Nëntorit dhe pandemisë së COVID-19. Komunikimi me UST është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 date 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi”**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nga dokumentacioni mbështetës u konstatua se programi i studimit është në harmoni me interesat kombëtare dhe me misionin e Universitetit të Sporteve të Tiranës të parashikuar në nenin 7 të Statutit të UST-së.  <i>Ref. Nr. 2, Statuti i Universitetit të Sporteve, Misioni, neni 7</i>			
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit përmbush misionin e UST-së për të ofruar programe studimi të standardeve akademike më të larta dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet në fushën e shkencave motore.  <i>Ref. Nr. 2, Statuti i Universitetit të Sporteve, Misioni, neni 7</i>			
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit MP në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi i shërben më së miri misionit të vet, por edhe misionit të UST-së, për të përgatitur specialistë në fushat e veprimtarisë fizike, shëndetit, fitnesit, rekreacionit, si edhe në fushat e turizmit sportiv e të aventurës.  <i>Ref. Nr. 2, Statuti i Universitetit të Sporteve, Misioni, neni 7; Ref. Nr. 4, Plani Strategjik FVFR 2016-2020, Misioni.</i>			
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit i përgjigjet nevojës së tregut për specialistë në qendrat e fitnesit, në qendrat turistike rekreative verore e dimërore, në qendrat e turizmit bregdetar dhe atij malor, duke i kontribuar zhvillimit të turizmit në rang lokal e kombëtar dhe rritjes së të ardhurave për këtë sektor të ekonomisë së vendit.  <i>Ref.Nr.7 Rregullore e programit të Studimit MP në Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi, Pika 3 .</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Nga dokumentacioni mbështetës që GVJ shqyrtoi si: <a href="#">Plani Strategjik i Universitetit të Sporteve si dhe Planin Strategjik të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit</a>, u konstatua se programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UST-së. Objektivat e zhvillimit të programit përkohë me objektivat e zhvillimit të vetë institucionit.</p> <p>Objektivat Institucionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Edukimi dhe formimi i studentëve për tu përgatitur si specialist të lartë, të aftësohen dhe të zhvillojnë punë të kualifikuara, duke kontribuar në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit.</li> <li>b) Përbushja e aspiratave të rinjve për zhvillimin e tyre në përshtatje me kohën dhe zhvillimit e vendit e ato botërore.</li> <li>c) Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies e përvetësimit të dijes.</li> <li>d) Modernizimi i metodave të mësimdhënies;</li> </ul> <p>Objektivat e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në programin e studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Rishikimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm të mësimnxënies, mësimdhënies, hulumtimit dhe shërbieve përkrahëse për studentët dhe stafin me synimin dhe në përthithjen e mendimit dhe kërkesave të studentëve sidomos të atyre të elites.</li> <li>b) Zhvillimit dhe përdorimit të komunikimit efektiv dhe të punës në një ekip ndërveprues.</li> <li>c) Kualifikimin dhe specializimin e mëtejshëm të pedagogëve që të kontribuojnë në perfeksionimin e menaxhimit të procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor</li> <li>d) Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit (FVFR) synon mbrojtjen me ligj të profesionit të Trajnerit të Fitnessit dhe Guidës Turistike, sepse ka një department në programet e të cilit reflektohen parimet kryesore të formimit të të diplomuarve në ciklin e pare dhe të dytë të studimeve.</li> </ul> <p><i>Ref. Nr. 3, Plani Strategjik UST 2016-2020, Objektivat, f. 5; Ref. Nr. 4, Plani Strategjik FVFR 2016-2020, Objektivat.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Dokumentet rregullatore të UST-së si Statuti e Rregullorja përcaktojnë në mënyrë të qartë njësitë kryesore në strukturën përbërëse të institucionit të cilat janë: Fakulteti i shkencave të Lëvizjes, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe nga Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit; drejtimit prioritar të diplomave që ofron, ku ndër to renditet përgatitja e specialistëve për aktivitetin fizik, sportin e rekreacionin, por edhe për fusha të reja specifike në përgjigje të kërkesave e interesave kombëtare.</p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin përkatës vihet re përputhje e plotë mes emërimit të programit të studimit MP në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi dhe drejtimet akademik të përcaktuar për të në statutin e institucionit.</p> <p>GVJ konstaton një përputhje të plotë mes fushave të programit të studimit dhe departamentit përgjegjës për realizimin e këtij programi, Departamenti i Veprimtarive Fizike, Rekreative dhe Turizmit.</p> <p><i>Ref. Nr. 2, Statuti i Universitetit të Sporteve, Misioni, neni 4, pika 1, neni 7, pika b.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit (FVFR) ka për qëllim të nxjerrë specialistë për fushën e fitnesit, shëndetit, turizmit sportiv e të aventurës, prandaj programi MP Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi plotëson këtë nevojë të shprehur në strategjinë e zhvillimit të institucionit, interesit kombëtar dhe trendet globale duke plotësuar një mangësi edhe të tregut të punës në këtë sektor.</p> <p><i>Ref. Nr. 36, Shkresë e dekanatit, datë 21.03.2018; Ref. Nr. 54, VKM, Nr. 41</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p><b>Standardi I.3</b></p> <p><b>Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Nga konsultimi me programin mësimor të programit të studimit GVJ konstaton se është organizuar në mënyrë të atillë që studenti në përfundim të studimeve të ciklit të dytë Master Profesional është i pajisur me njohuri bazë të formimit profesional.</p> <p>Objektivat në drejtim të formimit, aftësimit dhe punësimit të studentëve pas marrjes së diplomës janë të shprehura qartë në rregulloren e programit të studimit MP në “Aktivitet Fizik dhe Rekracioni - Trajner Fitnesi” dhe në Supplementin e diplomës që lëshohet në përfundim të studimeve MP.</p> <p>Master Profesional në Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi ka si mision:</p> <p>a) Të përgatisë specialist për Ativitetin Fizik dhe Shëndetin në qendrat e fitnesit, rekreacionit dhe resorteve turistike, etj.</p>

	<p>b) Aspektet kryesore të veprimtarisë së studimeve janë: mësimdhënia, kërkimi, dialogu akademik dhe botimet.</p> <p>c) Masteri Profesional në Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni e zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të një strategjie zhvillimi.</p> <p><i>Ref. Nr. 7, Rregullore e programit të studimit, neni 3, neni 6, neni 7.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet si produkt i Projektit Tempus IV “Harmonising Sport Science Curricula in the Balkans in the EU Perspective”. GVJ konstaton se sektori ALUMNI brenda Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni mbulon përgjegjësinë e mbajtjes së kontakteve me studentët e diplomuar dhe me punëdhënësit e fushës me të cilët ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike.</p> <p>Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar.</p> <p>Këto studime nuk janë të plota edhe sepse studentët pasi mbarojnë studimet, pothuajse shkëpusin marrdhëniet me Fakultetin.</p> <p>GVJ sugjeron që ky proces të marrë trajta edhe më formale, dhe database i të dhënave të pasurohet e të përditësohet, sidomos me informacionet e të diplomuarve të punësuar në sektorin privat.</p> <p><i>Ref. Nr. 3, Plani Strategjik UST 2016-2020,</i></p> <p><i>Objektivat, f. 7; Ref. Nr. 17, Studim i tregut të punës, projekti nr. Prot. 649/6;</i></p> <p><i>Ref. Nr. 17.1, Studim i tregut të punës, projekti “Fit Albania”;</i></p> <p><i>Ref. Nr. 64, Kalendari i aktiviteteve FVFR 2017-2019</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentacionit të marrë dhe intervistave të bëra me dekanin e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit si dhe me Përgjegjësin e Departamentit të programit të studimit të Masterit Profesional konstaton se dekanati, si edhe departamenti përgjegjës për programin merr masa që të përditësojë strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, duke u siguruar që kurrikula e programit t’i nënshtrohet një procesi të vazhdueshëm rishikimi e përmirësimi, që diploma e ofruar të jetë sa më afër nevojave të tregut si dhe ne përputhje me udhezimet e MASR, jo me shume se 20%, të cilat bëhen në fund të cdo viti akademik. Për ndryshimet në kurrikul caktohet një grup pune me pjesëmarrjen e stafit mësimor dhe kërkimor brenda departamentit i cili propozon ndryshimet në</p>

	<p>kurrikul, i paraqet ato te përgjegjësi i departamentit dhe në departament për diskutim dhe për cdo ndryshim të bërë. Këto propozime dergohen në dekanat, i cili pasi i aprovon merr masa që të përditësojë strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit</p> <p>GVJ konstatoi se këto ndryshime nuk janë bërë për Rregulloren e programit (sipas ligjit te ri të arsimit të lartë), prandaj sugjeron rishikimin e menjëhershëm të Rregullores së programit të studimit, duke e përshtatur dhe përditësuar me ligjin e ri të arsimit të lartë, në mënyrë të tillë që kurrikula e programit të studimit t’u lejoj të diplomuarve të thellojnë aftësimin e tyre profesional nëpërmjet diplomave të nivelit të dytë të ofruar nga fakulteti.</p> <p><i>Ref. Nr. 55, Vendim Nr. Prot. 791, datë 14.05.2018, “Mbi disa ndryshime të mëtejshme në planet mësimore”;</i></p> <p><i>Ref. Nr. 56, “Mbi ngritjen e grupit të punës për sigurimin e cilësisë së brendshme në programin e studimit MP”, Vendim nr. 1/1, datë 10.15.2018, Nr. Prot 45/2;</i></p> <p><i>Ref. Nr. 57, Shkresë e Ministrit të Arsimit, Nr. Prot. 6692/1, datë 31.08.2018</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara me Drejtorinë e Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni, ku në përbërje të kësaj drejtorie është edhe sektori i Njësisë së Standarteve dhe Kurrikulës, GVJ konstaton se metodologjia e studimit dhe e transformimit institucional është mbështetur në metodologjinë e projektit të Rrjetit Unikal European të Universiteteve të Sportit “AEHESIS” që synon harmonizimin e Kurrikulave të Shkencave sportive në Institucionet e Arsimit të Lartë në shtetet e Bashkimit European plotësisht në përputhje me zbatimin e procesit të Bolonjës.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavejeçare të institucionit dhe praktikata e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Diploma e MP Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi, e cila është e vetme në llojin e saj në rang Kombëtar, ndaj për hartimin dhe implementimin e saj janë ndjekur modelet më të mira Evropiane, si: Universiteti i Romës “Foro Italico”, Universiteti i Sporteve të Athinës, etj.</p> <p><i>Ref. Nr. 16 Projektit Tempus IV “Harmonising Sport Science Curricula in the Balkans in the EU Perspective”, “Projektit TEMPUS IV – “Balkansport</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi synon pajisjen e studentëve me aftësi profesionale në fushën e Aktivitetit fizik, Rekreacion dhe të Trajnerit të Fitnesit. Aftësimi praktik realizohet si nëpërmjet programit të praktikës ashtu edhe në trajtimin profesional.</p> <p>GVJ konstaton se programi përputhet plotësisht me profilin e UST dhe FVFR dhe me strategjinë e zhvillimit të UST. <i>Ref. Nr. 3 Plani</i></p>



	<i>Strategjik UST 2016-2020.</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në zyrën e burimeve njerëzore se rekrutimi i PAE dhe PAK bëhej konform legjislacionit në fuqi. Njësia bazë në bazë të programit mësimor, orëve për ngarkesën mësimore sipas <i>udhëzimit</i> nr. 29, datë 10.09.2018 Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë planifikon numrin e pedagogeve për rekrutim. Njësia bazë përcakton kriteret bazë dhe kriteret preferenciale të rekrutimit dhe këto kërkesa I paraqet në dekanat. Pasi aprovohen në dekanat, zyra e burimeve njerëzore shpall on.line afatet kohore të dorëzimit të dokumentacionit, kriteret e punësimit sipas legjislacionit në fuqi. Nga verifikimi I dosjeve të PAE dhe PAK u vu re që dosjet dhe rekrutimet ishin conform kërkesave të bëra nga njësia bazë dhe legjislacionit në fuqi. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit është me grada dhe tituj, dhe kualifikim të ciklit të dytë të studimeve, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë që zotërojnë titullin akademik “Profesor” janë Titullarët përgjegjës të lëndëve, ndërsa personeli akademik me kohë të plotë që zotërojnë gradën shkencore “Doktor” dhe “Msc” janë titullar moduli. Si titullarët përgjegjës të lëndëve, ashtu edhe titullarët e modulit zhvillojnë orët në auditor sipas normës përkatëse të lejuar, bazuar në kategoritë që mbartin gjithsecili.</p> <p>GVJ konstatoi se personeli Akademik i ka të gjitha kapacitetet për zhvillimin e moduleve, lëndë ose i gjithë programit në gjuhë të huaj, dhe kjo do të ndihmonte në rritjen e numrit të studentëve të huaj në këtë program studimi.</p> <p>GVJ sygjeron që gjuha e huaj në rekrutim të PAE dhe PAK të ketë më shumë pike vlerësimi, në mënyrë që numri i studentëve të huaj të jetë më i madh.</p> <p><i>Ref. Nr. 11.1 Procedurë rekrutimi personeli akademik administrativ në UST</i></p>			
<b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësisht të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	<p>Institucioni ka kapacitetin ligjor për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit që u përgjigjen nevojave të tregut për specialist ne fusha të caktuara.</p> <p><i>Ligji i Arsimit të Lartë Nr80/2015, Neni 3, pika 1b.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nukpërmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

Standardi I.4	
Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit. Në strukturën përbërëse të Fakultetit janë tri departamente: Departamenti i Veprimtarive Fizike, Rekreative dhe Turizmit (Dep. Përgjegjës për programin e studimit), Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit dhe Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit.</p> <p>Institucioni provon se në rang fakulteti dhe Departamenti përgjegjës ka të gjitha kapacitetet për ofrimin e një programi studimi cilësor.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Personeli Akademik Efektiv (PAE) në rang fakulteti (29 pedagogë) përbëhet nga:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Profesor,</li> <li>- 4 Profesorë të Asociuar,</li> <li>- 12 Doktor/Docent</li> <li>- 12 Msc.</li> </ul> </li> <li>• <u>Në nivel Departamenti përgjegjës për programin e studimit (9 pedagog) PAE:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Prof.As</li> <li>- 5 Doktor</li> <li>- 3 Msc</li> </ul> </li> </ul> <p>Dhe 1 Personel Akademik me Kontratë (PAK), me titullin Prof.As.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Në nivel programi studimi Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit numëron (20 pedagogë) si PAE:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 Prof</li> <li>- 3 Prof. As,</li> <li>- 10 Doktor</li> <li>- 5 Msc</li> </ul> </li> </ul> <p>Dhe 1 Personel Akademik me Kontratë (PAK), me titullin Prof.As.</p> <p><i>Ref. Nr. 23, Të dhëna tabelore për personelin akademik;</i></p> <p><i>Ref. Nr. 24, Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Fakultet/ departamentin përgjegjës.</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësishë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni–Trajner Fitnesi ofrohet në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit.</p> <p>GVJ konstaton se ka përputhje të plotë mes fushave të programit të studimit dhe fushave të fakultetit përgjegjës për ofrimin e tij.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësishë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitet bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni–Trajner Fitnesi ofrohet nga Departamenti i Veprimtarive Fizike, Rekreative dhe Turizmit. Evidentohet përputhje e plotë midis fushës së përgjithshme dhe specifike në fushën akademike e kërkimore të departamentit që ofron programin.</p> <p><i>Ref. Nr. 26. Të dhëna Tabelore për numrin e programeve që ofrohen në Njësinë përgjegjëse.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi i MP mbikqyret nga vet njësia kryesore që e ofron, pasi fusha e studimit që e mbulon masteritn profesional është në përputhje të plotë me fushën e studimit që mbulon njësia kryesore. Pjesa me e madhe e personelit akademik që japin mësim në master janë pjesë e personelit akademik të bachelorit.</p> <p><i>Ref. Nr. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik në Njësinë Kryesore dhe njësinë përgjegjëse.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				✓

<p><b>Standardi I.5</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni respekton legjislacionin në fuqi në drejtim të organizimit në njësi kryesore dhe njësi bazë. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive midis njësive të ndryshme është e rregulluar po kështu me anë të dokumenteve ligjore përkatëse në rang universiteti dhe në rang fakulteti, si Statuti i UST-së, Rregullorja e UST-së dhe Rregullorja e FVFR-së, ka të përcaktuar qartë funksionet e organeve përbërëse të institucionit. Departamenti i Veprimtarive</p>

	<p>Fizike, Rekreative dhe Turizmit, si departamenti përgjegjës për programin, zhvillon veprimtarinë më të madhe për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit. <u>Bazuar ne dokumentacionin e vene ne dispozicion si dhe takimet me koordinatorin e programit e stafin akademik</u> rezulton se kjo veprimtari kryhet duke respektuar dispozitat e parashikuara në Rregulloren e UST-së për drejtuesin e njësisë bazë dhe përgjegjësën e grupit mësimor-kërkimor brenda kësaj njësie, neni 22 i Statutit dhe i Rregullores.</p> <p><i>Ref. Nr. 58, Ligji i Arsimit të Lartë Nr. 80/2015; Ref. Nr. 2, Statuti i Universitetit të Sporteve, neni 22; Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 22, 23; Ref. Nr. 6, Rregullore e FVFR, neni 17.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UST dëshmon se ka një bashkëpunim të frytshëm në rang institucional me institucione partnere në shkallë vendi dhe më gjerë, IAL kombëtare e ndërkombëtare me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Po kështu konstatohet bashkëpunim në nivel institucional me institucione e organizma kombëtare në funksion të realizimit të praktikave profesionale. Vihen re edhe përpjekje në rang fakulteti për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi me universitete dhe institucione partnere brenda dhe jashtë vendit, si partnerë strategjikë për ofrimin e programit të studimit: ku permendim instruktim per metodikat e sporteve dimerore nga lektoret nga Universiteti i Aradit, instruktim per metodikat e sporteve ujore nga lektoret e Kolegjit NOVA -Hollande etj), me aktorë nga fushës se biznesit (Poliklinika Gjermane, Shoqata Rafting Albania etj.), institucione që operojnë në sektor (KOKSH, AZHR, Agjensia e Parqeve dhe Rekreacionit, etj.)</p> <p><i>Ref. Nr. 34, Lista e subjekteve bashkëpunuese në nivel IAL-je dhe me institucione të tjera të UST-së; Ref. Nr. 32, Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale; Ref. Nr. 4, Plani Strategjik FVFR 2016-2020, Objektivat.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ konstatoi nga takimi me drejtuesit e institucionit dhe me stafin akademik si dhe dokumentacioni I vënë në dispozicion se nga marrëveshje të ndërsjellta të bashkëpunimit institucioni përfiton në drejtim të shkëmbimeve të stafit akademik, shkëmbimit të studentëve, infrastrukturës mësimore dhe realizimit të programit mësimor.</p> <p>Në përputhje me specifikat e programeve të studimit që ofrohen nga institucioni, marrëveshjet në kuadër të realizimit të praktikave profesionale janë të domosdoshme për arritjen e objektivave mësimore dhe profesionale të programit të studimit. Marrëveshjet e shumta të lidhura me institucione publike dhe kompani private, si p.sh. marrëveshjet me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit,</p>

	<p>Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federatën Shqiptare të Rafting, Poliklinikën Mjekësore Gjermane, Shoqatën e Rehabilitimit Fizik për Personat me Aftësi të Kufizuara, etj.</p> <p><i>Ref. Nr. 35, Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve; Ref. Nr. 4, Plani Strategjik FVFR 2016-2020, Objektivat.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Bashkëpunimi mes Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe agjensive e institucioneve publike rregullohet përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura mes palëve. Ndërsa kryerja e praktikave mësimore në subjekte private realizohet përmes sponsorship-it.</p> <p>Bazuar mbi dokumentacionin e vene ne dispozicion GVJ konstatoi se Institucioni ka vendosur marrëdhënie zyrtare ne parim e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës por ka nevojë per permiresimet si me poshte vijon.</p> <p>Në mungesë të një marrëveshje të shkruar, procesi i praktikës profesionale rregullohet prej rregullores së institucionit. GVJ konstaton se ka nevojë që kjo marrëdhënie të jetë e formalizuar me kontrata ligjore, me qëllim që të garantohet një process cilësor i praktikës profesionale.</p> <p><i>Ref. Nr. 34, Lista e subjekteve bashkëpunuese në nivel IAL-je dhe me institucione të tjera të UST-së; Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 68-71; Ref. 4.1, Deklarata e Misionit të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Objektivat 2020-2022, pika 1.1.6.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Në përputhje me nevojat e tregut dhe me sferën akademike në të cilën lëvron, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit ofron mundësi për certifikimin dhe ricertifikimin e Udhërrëfyesve Turistik të Specialitetit të Veçantë.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni i shqyrtuar vëren se prej Marrëveshjeve të ndërsjellta të bashkëpunimit Institucioni përfiton kryesisht në pesë drejtime të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Mobilitet i Stafit Akademik, nga pjesëmarrja në programet e shkëmbimit, sic është veprimtaria në kuadër të projektit ERASMUS+, ky shkëmbim i dyanshëm rezulton në një rritje të cilësisë së praktikave mësimdhënëse.</li> <li>2) Mobiliteti i studentëve, pjesë e programeve të shkëmbimit janë dhe studentët e ust-së, aplikojnë për të ndjekur pjesë të programit mësimor në universitete partnere të huaja.</li> <li>3) Infrastruktura, pjesëmarrja në projekte të ndryshme TEMPUS, e ka pasuruar Universitetin jo vetëm me programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve por edhe i ka kontribuar shtimit e</li> </ol>

	<p>përmirësimin të infrastrukturës laboratorike në funksion të procesit të mësimdhënies.</p> <p>4) Trajnim për stafin akademik dhe stafin administrative në drejtim të teknologjisë e pajisjeve laboratorike, në kuadër të projekteve TEMPUS është përfituar trajnim për stafin në drejtim të përditësimit me zhvillimet më të fundit të teknologjisë në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>5) Praktika Profesionale, në përputhje me specifikat e programeve të studimit që ofrohen nga institucioni, marrëveshjet në kuadër të realizimit të praktikave profesionale janë të domosdoshme, për arritjen e objektivave mësimore dhe profesionale të programit të studimit.</p> <p>FVFR ka si objektiv për 2016-2020 të thellojë edhe më shumë procesin e marrjes së feedback-ut me qëllim përmirësimin e programeve mësimore.</p> <p><i>Ref. Nr. 35. Raport mbi Përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</i>  <i>Ref. Nr. 4. Plani Strategjik FVFR 2016-2020, Objektivat e Hartimit të Programeve të Studimit, f.4.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ konstaton se organizimi i programit të studimit është kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi i organizuar në lëndë, të cilat më pas organizohen në module dhe vlerësohen përkatësisht me kredite sipas Sistemit Evropian të Krediteve (ECTS). Numri i krediteve për një lëndë varion nga 4 deri në 8 kredite (ECTS). Punimi i diplomës/provimi përfundimtar. Totali i krediteve që studenti duhet të grumbullojë në përfundim të programit të studimit është 60 ECTS. GVJ konstatoi se programi mësimor përmban raportet e duhura në

	<p>elementet përbërës të tij: leksione, seminare, ushtrime sipas udhëzimeve të ministrisë dhe kartës së Bolonjës.</p> <p>Lëndët janë strukturuar me Lëndë të cilat përmbajnë dy ose më shumë module (9 Lëndë/19 module) me ndarjen në kredite (ku një krediti të studimeve universitare i korrespondojnë 25 orë mësimore dhe pune të studentit), përfshirë provimet që jepen në semestrin e parë dhe të dytë, si dhe teza e provimit përfundimtar.</p> <p>Po kështu programi për vitin akademik 2019-2020 përfshin kategorizimin e lëndëve: bazë, të përgjithshme, karakterizuese etj. Plani mësimor përfshin, 19 Module, praktikën dhe mbrojtjen e tezës.</p> <p>Plani mësimor ka karakter ndërdisiplinar me bosht kryesor përgatitjen e specialistëve të veprimtarisë fizike.</p> <p>GVJ mendon se ky program ka kreditet e duhura për cdo Modul/Lëndë.</p> <p><i>Ref. Nr. 14, Plani mësimor 2019-2020, MP</i></p> <p><i>Ref. Nr. 53. Manual Studenti I Ust-së.</i></p> <p><i>Ref.7. Rregullorja e programit të studimit; Plani mësimor. neni 24; 24.1; 24.2.</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Diploma MP në Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnessi u ofron studentëve, krahas njohurive bazë me karakter të formimit profesional, edhe njohuri specifike në fushën e shkencave të aktivitetit fizik, shëndetit dhe rekreacionit dhe në shkencat e lëvizjes e sportit. Për rrjedhojë edhe sferat profesionale që ofron kjo diplomë janë po kaq të gjera e të larmishme, ku misioni i këtij programi është të përgatisë specialistë për Aktivitetin Fizik dhe Shëndetin në qendrat e fitnesit, rekreacionit dhe resorteve turistike, në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federatën Shqiptare të Rafting, Poliklinikën Mjekësore Gjermane, Shoqatën e Rehabilitimit Fizik për Personat me Aftësi të Kufizuara</p> <p><i>Ref. Nr. 15.1. Suplementi i Diplomës MP, pika 4.2.b.</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ konstaton se në përshtatje me kurrikulën cdo departament i propozon Këshillit të Fakultetit miratimin e një numri të caktuar lëndësh me zgjedhje bazuar dhe në udhëzimet e MASR, kjo u evidentua gjatë intervistës me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit.</p> <p>Programi i studimit është i organizuar në disiplina të detyrueshme dhe disiplina me zgjedhje. Disiplinat e detyrueshme që kanë peshën më të madhe specifike të programit parashikojnë veprimtari shkencore të fushës së diplomimit. Disiplinat me zgjedhje përfshijnë veprimtari shkencore të synuara për një specializim më të ngushtë. Detyrimi përmbyllës realizohet në trajtën e një provimi përfundimtar formimi që i jep mundësi studentit të reflektojë shkallën e përvetësimit të parimeve shkencore në fushën e diplomimit.</p> <p><i>Ref. Nr. 5. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 37 pika 1, 2, 3.</i></p>

<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Krahas lëndëve teorike, studentët e FVFR ndjekin studimet për pesë lëndë me karakter praktik, siç janë Lëndët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lojra Sportive, e ndarë në modulet Metodologjia e Sporteve Rekreative dhe Lojra Sportive (Bb, Vb, Fb),</li> <li>- Disiplina e Sporteve individuale Rekreative, e ndarë në dy module Metodologjia e sporteve Individuale Rekreative (fitbox, crossfit) dhe Pilates Kompozim Danci.</li> <li>- Trajningu Profesional me tre module Trajningu me Kategori të ndryshme të Popullatës, Stërvitja e Adaptuar me Grupe Specifike Shoqërore dhe Fitnesi i Avancuar dhe Trajningu Personal.</li> <li>- Turizëm Rekreativ me dy module Turizëm Rekreativ dhe Metodika e Organizimit të Sporteve Ujore.</li> <li>- Lënda Praktika Profesionale me një modul Aktivitet Fizk dhe Shëndeti.</li> </ul> <p>Këto lëndë janë ndërtuar jo vetëm duke synuar pajisjen e studentëve me njohuri të përgjithshme për teknikat e këtyre veprimtarive, por edhe me synimin për t'i aftësuar studentët për të qenë të aftë profesionalisht, çka nënkupton pajisjen e studentëve me aftësi për të zgjidhur probleme specifike të fushës përmes aplikimit në praktikë të njohurive teorike.</p> <p>GVJ konstaton se struktura e studimeve në ciklin e dytë të studimeve është konform programit sipas kartës së Bolonjës.</p> <p>Programi i studimit është hartuar duke respektuar dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015, neni 75 referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi ofrohet me 60 ECTS, me kohëzgjatje të normale të parashikuar 1 vit akademik. Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e provimit përfundimtar. <i>Ref. Nr. 59. Model Programi i Lëndëve Praktike, Rezultatet e të nxënit.</i></p>
<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë të grupuara në 5 kategori të emërtuara A, B, C, D, E. Studenti merr:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 8 ECTS nga Lëndët bazë (A);</li> <li>- 21 ECTS nga Lëndët karakterizuese (B);</li> <li>- 12 ECTS nga Lëndët ndërdisiplinore (C);</li> <li>- 12 ECTS nga Lëndët plotësuese dhe (D);</li> <li>- 7 ECTS nga Detyrimet përmbyllëse (E).</li> </ul> <p>Ngarkesa normale është 60 kredite/vit, e ndarë në 29 ECTS dhe 31 ECTS për semestër. Studentët që përfundojnë studimet në këtë program studimi diplomohen me të paktën 60 ECTS.</p>



	<p>Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p><i>Ref. Nr. 14. Plani mësimor 2019-2020, MP në “Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni –Trajner Fitnesi Ref. Nr. 7. Rregullore e programit të Studimit MP në Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi, Neni 3.</i></p>			
<p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale. Në Planin Mësimor të Programit të MP Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi janë parashikuar 5 kredite për mbulimin e Praktikës Profesionale sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p> <p><i>Ref. Nr. 54. VKM Nr.41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL” .</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>✓</p>

<p><b>Standardi II.2</b></p> <p><b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Veprimtarive Fizike, Rekreative e Turizmit është department në përbërjen e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe ushtron aktivitetin e tij në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi që nga koha e krijimit të këtij fakulteti me VKM Nr. 515, datë 30.06.2010. Me vendim të Dekanit, Nr. Prot. 271, datë 17.02.2017, ky departament është përgjegjës për programin e studimit Master Profesional “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi”.</p> <p>GVJ konstaton se departamenti merr masa për mbikëqyrjen e veprimtarisë në drejtim të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Departamenti plotëson kriterin ligjor (min 7 pedagogë të brendshëm /3 me tituj/grada) sepse përbëhet nga 9 pedagogë si PAE:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Prof. As,</li> <li>- 5 Doktor</li> <li>- 3 Msc</li> </ul> <p>dhe 1 Personel Akademik me Kontratë (PAK), me titullin Prof.As.</p> <p>Organizimi dhe struktura e departamentit përgjegjës për programin e studimit MP në Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi përmbush detyrimet ligjore.</p> <p>Departamenti i Veprimtarive Fizike, Rekreative e Turizimit angazhon edhe 7 personel akademik (2 Dr. dhe 5 MSc.) nga njësitë e tjera të UST-së të në mësimdhënie pranë departamentit. Për shkak të specifikave të UST-së, thuajse e gjithë ngarkesa mësimore e programit të studimit mbulohet nga PAE.</p> <p><i>Ref.Nr.24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit.</i></p> <p><i>Ref. Nr. 16.1. VKM 515, datë 30.06.2010.</i></p> <p><i>Ref. Nr. 36. Vendim Nr. Prot. 271, datë 17.02.2017 mbi Departamentet përgjegjëse për programet e studimit të FVFR.</i></p> <p><i>Ref.Nr. 57. Komisioneve të Vlerësimit të programeve të Studimit MP Vendim nr. Prot 1603/1, datë .30.09.2019.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Fakulteti FVFR në nivel njësie kryesore ka 29 pedagogë pjesë e organikës së Fakultetit. Për rrjedhojë raporti personel akademik efektiv/Personel akademik i ftuar është 29 me 1 (29 studentë /1 PAK), raport ky në përputhje me standardin e shprehur në VKM Nr.418, datë 10.05.2017 (ku 70 % e programeve duhet mbuluar nga stafi PAE)</p> <p>Departamenti në përputhje me rregulloren e fakultetit dhe të institucionit është i organizuar në grupe mësimore-kërkimore, veprimtaria e të cilave mbikëqyret nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Gjithashtu GVJ konstaton se janë zbatuar raportet e grupeve të studimit me numër studentësh për fushën e Shkencave Humane dhe Arteve.</p> <p><i>Ref.Nr.60. VKM 418, datë 10.05.2017, Aneksi 1 (Ref 60).</i></p> <p><i>Ref.Nr.5. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 22 pika 6; Ref.Nr.6. Rregullore e FVFR-së, neni 17, pika 5.</i></p> <p><i>Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit/ Kualifikimi dhe Raportet.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>GVJ konstatoi se Departamenti i Veprimtarive Fizike, Rekreative e Turizimit përgjegjës për programin e studimit të MP Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni -Trajner Fitnesi angazhon për realizimin e planit mësimor PAE, PAK dhe personel akademik ndihmës të parshikuar në Ligjin e Arsimit të Lartë për njësinë bazë 80/2015 si dhe <b>Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të</b></p>

	<p>personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>GVJ nga inspektimi në zyrën e burimeve njerëzore vuri re se ashtu si për PAE edhe për personel akademik ndihmës njësia bazë paraqet kërkesat dhe kriteret në dekanat dhe pas aprovimit nga dekanati, zyra e burimeve njerëzore shpall online konkursin për dorëzimin e dokumentacioneve dhe kriteret e paracaktuara nga njësia bazë.</p> <p>(Ref Nr.58).</p> <p><i>Ref.Nr.24. Tabela përkatëse e stafit ndihmës akademik.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Koordinatorit i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e Universitetit e ngarkon drejtuesin e njësisë bazë/ departamentit me funksionet e hartimit të programeve mësimore, dhe të mbikëqyrjes së ecurisë së programit të studimit.</p> <p>Koordinatori i programit është me gradën Dr.</p> <p>Koordinatori i programit ngre grupe pune për shqyrtimin e cilësisë së silabuseve, miraton temat e diplomave dhe tezat e provimeve. Gjithashtu koordinatori i programit ndjek ecurinë e zhvillimit të praktikave profesionale.</p> <p>Koordinatori i Programit në bashkëpunim me njësinë bazë dhe atë kryesore raporton në mënyrë periodike dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p> <p>Nga dokumentimi i procesit te vene ne dispozion nga UST dhe takimet me koordinatorin e programit, stafin akademik dhe studentet GVJ vlereson se koordinatori ka realizuar detyrat ne perputhje me kuadrin rregullator ne fuqi.</p> <p><i>Ref.Nr.5. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 23 pika 2 a, d.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë ose departamenti përgjegjës programin e studimit ruan e arkivon në mënyrë të rregullt dokumentacionin për përmbajtjen e programit e studimit. Kopje të dokumenteve depozitohen në dekanat. Organizimi dhe struktura e programit të studimit janë edhe të publikuara në website-n e Universitetit në hapësirën e Fakultetit respektiv.</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë, module, praktikë e veprimtari formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Kjo gjen pasqyrim në planin mësimor të programit të studimit.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit është i organizuar në lëndë e module të cilat vlerësohen me ECTS. Numri maksimal i krediteve të grumbulluara në fund të studimit Master Profesional është 60 ECTS, të shpërndara në mënyrë të barabartë nëpër 2 semestra përkatësisht me nga 29 ECTS dhe 31 ECTS.</p> <p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë të grupuara në 5 kategori të emërtuara A, B, C, D, E :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 8 ECTS nga Lëndët bazë (A);</li> <li>- 21 ECTS nga Lëndët karakterizuese (B);</li> <li>- 12 ECTS nga Lëndët ndërdisiplinore (C);</li> <li>- 12 ECTS nga Lëndët plotësuese dhe (D);</li> <li>- 7 ECTS nga Detyrimet përmbyllëse (E).</li> </ul> <p>Plani mësimor i programit të studimit pasqyron në mënyrë të detajuar informacionin në lidhje me shpërndarjen e lëndëve dhe moduleve në semestra dhe ngarkesën mësimore në auditor për secilin prej këtyre elementeve.</p> <p>Ndërsa në <a href="#">Rregulloren e UST-së</a>, në <a href="#">Rregulloren e FVFR</a> (aprovuar në vitin 2013 dhe amenduar në vitin 2017) gjendet informacioni për frekuentimin e programit dhe mënyrën e vlerësimit, informacion ky që gjendet i pasqyruar edhe në programin mësimor të çdo lënde e moduli.</p> <p>Për frekuentimin UST ka vendosur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për leksionet detyrimi është 50%</li> <li>- Për seminarët detyrimi është 50%-75%</li> <li>- Për ushtrimet detyrimi është 65%-75%</li> <li>- Për praktikat mësimore detyrimi është 80%</li> <li>- Për laboratorët detyrimi është 100 %</li> </ul> <p>Në <a href="#">Rregulloren e programit të studimit</a> detyrimet mungojnë (IAL ka paraqitur Rregulloren e aprovuar në vitin 2013)</p> <p>Në syllabuse pedagogët në kuadër të lirisë së tyre akademike kanë edhe raporte të tjera psh: në disa syllabuse është shkruar detyrimi për leksionet 75%. Kjo është e mirëpritur dhe i takon Departamentit dhe koordinatorit të propozojë ndryshimet pozitive në rregulloren e programit.</p>
---	--




	<p><i>Ref.Nr.5. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 41, 50, 61 ;</i>  <i>Ref.Nr.6. Rregullore e FVFR-së, neni 38, 47, 58 ;</i>  <i>Ref.Nr.7. Rregullore e programit të Studimit MP në Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi, Neni 3; Neni 20, 24, 26.</i>  <i>Ref.Nr.14. Plani mësimor 2019-2020, MP në “Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni –Trajner Fitnesi”.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Kriteret për pranimin e studentëve që ndjek FVFR për programin e studimit MP Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi janë pasqyrim i legjislacionit në fuqi dhe specifikave të fakultetit që ofron programin e studimit.</p> <p>Ndjekja e një programi të dytë studimi, procesi i pranimit rregullohet me anë të rregullores së UST-së. Po kështu rregullohet edhe procesi i transferimit të studentëve nga IAL të tjera drejt UST dhe anasjelltas dhe ekuivalentimi i një pjese ose i të gjithë programit. Fakulteti shpall kriteret mjaft kohë para pranimit dhe i bën ato publike në website-n e institucionit në hapësirën: Program Studimi Master Profesional <a href="http://fvfr.ust.edu.al/master-profesional/">http://fvfr.ust.edu.al/master-profesional/</a>.</p> <p>Kritere të përgjithshme janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pranoen për tu regjistruar kandidatw që zotërojnë DNP, DND.</li> <li>- Kandidatët që janë të fushës së veprimtarisë fizike dhe rekreacionit.</li> </ul> <p>Kritere specifike janë :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pranoen studentë nga Kosova, Presheva-Bujanovca, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbia e Mali i Zi nëse kandidatët zotërojnë gjuhën shqipe.</li> </ul> <p><i>Ref.Nr.61. Kriteret e Pranimit në ciklin e dytë të studimeve në MP Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi Nr. 268 Prot, datë 07.02.2019 për “mbi Përcaktimin e notës mesatare më të lartë” .</i></p> <p><i>Ref.Nr.5. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 44, 86, 87, 88 ;</i>  <i>Ref.Nr.6. Rregullore e FVFR-së, neni 41, 81, 82, 83, 84, 85;</i>  <i>Ref.Nr.47. Përcjellje e kriterëve të pranimit në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët</p>	<p>Programet e lëndëve dhe moduleve përbërese të tyre janë hartuar në përputhje me kërkesat ligjore për përmbajtjen dhe formatin e tyre, që janë të pasqyruara edhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Në program gjendet informacioni në lidhje me objektivat e lëndës, temat e lëndës, format e kontrollit të dijeve dhe mënyra e vlerësimit.</p>




<p>formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet e lëndëve janë subjekt rishikimi para çdo viti akademik me qëllim përditësimin e tyre.</p> <p>Drejtuesi i departamentit përgjegjës, njëkohësisht edhe kordinatori i programit ngre grup pune për vlerësimin e cilësisë së programeve të lëndëve.</p> <p>Në syllabuset e paraqitura për vitin akademik 2017-2018 vlerësimi gjithëvjetor i studentëve është i paraqitur me detaje.</p> <p>Në syllabuset e paraqitura për vitin akademik 2019-2020, ky element mungon, ndoshta sepse janë të organizuara në Lëndë ku futen disa module.</p> <p>Por GVJ mendon se ky element i vlerësimit vjetor duhet të jetë i pasqyruar qartë dhe me detaje.</p> <p><i>Ref.Nr.54. VKM Nr.41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", Shtojca Nr. 2.</i></p> <p><i>Ref.Nr.7. Rregullore e programit të Studimit MP në Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnessi, Neni 5.</i></p> <p><i>Ref.Nr.56. Model Vendim 1/2, Nr. Prot. 45/3, datë 05.10.2018 "Mbi ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e programeve të lëndëve/moduleve në programin e studimit të MP.</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Në fund të çdo viti kalendarik, çdo departament i njësisë kryesore bën analizën vjetore të punës për vitin përkatës. Ndër çështjet që planifikohen të diskutohen janë propozime të personelit akademik në drejtim të zhvillimit të lëndëve të caktuara. Këto diskutime dokumentohen në një dokument final dhe i përcillen dekanatit. Propozimet që gjykohen me vlerë për t'u implementuar mbahen shënim për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p>Për këto propozime ngrihet një grup pune me përfaqësues nga dekanati që më pas të çojë për miratim Senatit Akademik ndryshimet deri në masën 20%.</p> <p><i>Ref.Nr.38. Model Analize vjetore e Departamentit të Veprimtarive Fizike, Rekreative e Turizmit.</i></p> <p><i>Ref.Nr.52. Relacion mbi ndryshimet në planet mësimore, Nr. Prot. 689, datë 27.04.2018.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			✓	

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Studimet e ciklit të dytë në MP, ofrohen me kohë të plotë, dhe me kohëzgjatje normale 1 vit akademik. Studimet në këtë cikël realizohen me, së paku, 60 kredite, konform legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Ref.Nr.58. Ligji Nr. 80/2015, Neni 75, pika 6.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Emërtimi i programit të studimit MP në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnessi është në përputhje me fushën e studimit të cilën mbulon programi.</p> <p>Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A-ja deri te E-ja. Të gjitha lëndët e ofruara në këtë program, synojnë paisjen e studentëve me njohuri dhe aftësi që mund t'i ndihmojnë për tregun e punës.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit për secilin vit të studimeve është organizuar të shtrihet përgjatë 2 semestrave me kohëzgjatje normale 15-16 javë. GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestrat e kohëzgjatjes së programit është e balancuar që të mundësojë arritjen e rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p> <p><i>Ref.Nr.6. Rregullore e FVFR-së, neni 32.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit MP është hartuar mbi harmonizimin kurrikular e institucional me Rrjetin e Evropian të Universiteteve të Sportit dhe është implementuar në kuadër të Projektit TEMPUS IV – “Balkansport”.</p> <p>Në strukturën e programit evidentohet një përpjekje për ta përafuar kurrikulën me programe MP të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare homologe, në drejtim të emërtimit të lëndëve, ngarkesës së krediteve dhe ruajtjes së raportit teori/praktikë në përputhje me profilin e programit.</p> <p>Raporti <b>Teori</b> (orë leksioni) / <b>Praktikë</b> (orë për seminare/ laboratorë/ praktika përofesionale) rezultojnë: <b>32% me 68%</b></p> <p><i>Ref. Nr.16. Projektit Tempus IV “Harmonising Sport Science Curricula in the Balkans in the EU Perspective”, “Projektit TEMPUS IV – “Balkansport.”</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Duke ndjekur parimet ndërkombëtare të ndërtimit të programit mësimor, kurrikula e programit garanton mundësinë e transferimit gjatë studimeve ose në përfundim të ciklit të studimeve. Në 3 vitet e fundit një studente e ciklit të dytë, ka kryer një semestër në Universitetin e Romës, Itali, në kuadër të programit Erasmus +.</p> <p><i>Ref.Nr.35. Vendim: Nr.6 datë: 06/04/2016 Nr.400 Prot (Mobilitet Studentash në Programin Erasmus+.</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Pasi u njoh me dosjen e programeve/syllabuseve të lëndës, GVJ konstaton se institucioni ndjek praktikën e rishikimit dhe përmirësimit të syllabuseve, si në drejtim të përmbajtjes, ashtu edhe në drejtim të formës. Kjo e fundit ka akoma vend për përmirësim.</p> <p>Në drejtim të përmbajtjes vihet re se, në përgjithësi literatura bazë dhe e rekomanduar e përfshirë në Programin e Lëndës përfshijë tituj që datojnë jo më herët se 5 (pesë) vitet e fundit dhe që janë botuar nga shtëpia botuese Human Kinetics, autoriteti në fushën e studimit bazuar dhe në informacionin e perftuar nga takimi me punonjësit e bibliotekës së UST. Nga informacioni i vënë në dispozicion dhe takimi me punonjësit e bibliotekës së UST rezultoi se “Literatura bazë” për lëndët gjendet në bibliotekën e UST, ku është funksional indeksimi online i titujve si dhe menaxhimi përmes kartelave përkatëse të studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Nga bisedat me Drejtorinë e Koordinimit, Marrëdhënive me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni GVJ konstaton që një pjese e mirë e studentëve janë tashmë të punësuar nëpër qendra fitnesi (prandaj mesimi bëhet pasdite).</p> <p>Në përputhje me objektivat për programe studimi të ciklit të dytë, programi i studimit MP në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi synon që të pajisë studentët me njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit dhe aftësi drejt një profesioni apo license profesionale; aftësi bazë për punë kërkimore; aftësi të përgjithshme praktike, aplikative etj.</p> <p>Të gjitha lëndët e ofruara në Programin e Studimit MP në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi, synojnë paisjen e studentëve me njohuri dhe aftësi që mund t’i ndihmojnë për tregun e punës, përfaqse sa më të mirë sociale dhe ekonomike.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit i ndërtuar mbi parimin e raportit praktikë/teori në shifrat 32% me 68%, është një program që kombinon teorinë dhe praktikën, çka mundëson përvetësimin e dijeve bashkëkohore, aftësive të përgjithshme praktike. Përfundimi me sukses i ciklit master profesional, u jep mundësinë studentëve për të punuar si specialistë në sektorë të ndryshëm.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				✓

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit është me grada dhe tituj, dhe kualifikim të ciklit të tretë të studimeve ose janë në procesin e mbrojtjes së doktoraturës, për raste të veçanta japin mësim edhe me studime Master i Nivelit të Dytë, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.</p> <p>Personeli akademik i Brendshëm (PAE) rezulton se është (21 gjithsej) me këtë kualifikim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 5 Prof As</li> <li>- 8 Dr/PhD</li> <li>- 7 Msc</li> <li>- 1 SPA</li> </ul> <p>Personeli akademik i Jashtëm (PAK) rezulton se është (1 gjithsej)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Prof As</li> </ul> <p>Për personelin akademik me kualifikimin Msc Institucioni deklaron se është i përgatitur për specialitetet e vecanta që kërkon ky program, për të cilin mungojnë titujt dhe gradat. Aq më tepër që vitet e fundit janë bllokuar nga MASR programet e doktoratës.</p> <p><b>Raporti është 95% PAE dhe 5% PAK</b></p> <p><i>Ref.Nr.14. Plani mësimor 2019-2020, MP në “Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni –Trajner Fitnesi” Neni Nr.18.2.</i></p> <p><i>Ref Tabela permbledhese (plani mesimor 2019-2020)</i></p> <p><i>Ref.Nr.24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar për zhvillimin e lëndëve/moduleve është me grada e tituj, ose kualifikime të ciklit pasardhës (MSc.). Ndarja e lëndëve është bërë në përputhje me fushën e ekspertizës të secilit prej tyre, specifikën e moduleve. Gjithashtu, stafi akademik, është i përfshirë edhe në projektet e kërkimore kombëtare, që janë në përputhje me programin e studimit dhe ekspertizën e tyre.</p> <p><i>Ref.Nr.43.1. Mbi miratimin e projekteve shkencore për vitin akademik 2017-2019.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në</p>	<p>Për zhvillimin e praktikave profesionale në mënyrë cilësore, me ndihmën e Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënies me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni janë lidhur memorandume bashkëpunimi me institucione publike dhe kompani private, në rang institucioni dhe fakulteti. Kjo zyrë mban komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione. Tërheqim vëmendjen te formalizimi i marrëdhënies me partnerët nga</p>

<p>praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>sektori privat në funksion të një bashkëpunimi më produktiv në drejtim të praktikës profesionale. Departamenti apo fakulteti fton ekspertë të fushës të cilët mbajnë leksione të hapura në përputhje fushat e studimit të programit. Mbikëqyrja dhe ndjekja e seancave kryhet nga një pedagog që është pjesë përbërëse e njësisë së këshillimit të karrierës në nivel fakulteti. Për studentët të cilët zgjedhin të kryejnë punim diplome si detyrim përmbyllës, departamenti vepron në përputhje me dispozitat e parashikuara në Rregulloren e institucionit për procesin e diplomimit dhe Rregulloren e Diplomimit.</p> <p><i>Ref. Nr. 32, Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale;</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Pranë çdo njësie bazë ka të angazhuar Personel Ndhmës Mësimor, përgjegjës për mirëmbajtjen e ambienteve laboratorike dhe ambienteve të tjera mësimore. Të drejtat dhe përgjegjësit e personelit ndihmës mësimor janë të parashikuara në rregulloren e institucionit. Në rang fakultetit numërohen 5 personel ndihmës mësimor.</p> <p><i>Ref.Nr.5. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 30.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				✓

<p><b>Standardi II.6</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Platforma <a href="http://alumni.ust.edu.al/">http://alumni.ust.edu.al/</a> siguron feedback virtual nga partnerët privatë përmes ofertave të punësimit të shpallura prej këtyre të fundit në platformën online.</p> <p>Raporti mes kërkesë dhe ofertës për një vend pune siguron feedback të besueshëm i cili duhet të merret parasysh dhe të reflektohet në përmbajtjen e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të përmirësimit të programit të studimit institucioni përfshin në diskutime edhe studentët. Në grupin e punës për sigurimin e cilësisë së programeve të lëndëve për programin e studimit MP është përfshirë student përkatës.</p> <p><i>Ref.Nr.56. Model Vendim 1/2, Nr. Prot. 45/3, datë 05.10.2018 “Mbi ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e programeve të lëndëve/moduleve në programin e studimit të MP.</i></p>

<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Institucioni nëpërmjet Drejtorisë së Koordimit, Marrëdhënieve me Jashë, Këshillimit të Karrierës, Alumni është përgjegjëse për databazën dhe kontaktet studentore.			
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike e private e njësitë e pushtetit vendor me anë të së cilave përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me nevojat specifike lokale, siç është Marrëveshja me Agjensinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë.  <i>Ref.Nr.35. Marrëveshje Bashkëpunimi me Agjensinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni dëshmon se është i hapur ndaj metodave më inovative në mësimdhënie që kërkojnë adoptimin e zhvillimeve më të fundit të teknologjisë në këtë fushë, dhe është i gatshëm t'i implementojë ato.  Përveç kësaj institucioni siguron trajnimin e nevojshëm për stafin akademik që t'i ndërthurin ato në veprimtarinë e tyre të mësimdhënies.  Zhvillim domethënës ka qenë kalimi nga regjistrimet në format hard copy në platformën elektronike, hapësirë që përdoret nga stafi akademik dhe nga studentët. Për këtë institucioni mundësoi takime orientuese ndërmjet stafit dhe ekspertëve IT të platformës. Po kështu institucioni zhvillon takime informuese për të orientuar stafin në

	<p>veprimtarinë e tyre kërkimore-shkencore dhe në lidhje me publikime në revista shkencore me zë në fushën e studimit.</p> <p><i>Ref. Nr. 46 Udhëzues për përdorimin e SIMS; Konstatim i bërë gjatë takimit me Koordinatorin institucional, përfaqësues të Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në përputhje me Rregulloren e institucionit, zbatimi i programit mësimor është një proces që mbikëqyret në mënyrë periodike përgjatë shtrirjes së vitit akademik nga zëvendësdekani në bashkërendim me drejtuesin e njësisë bazë, përgjigjës/koordinator i programit të studimit. Në fund të çdo semestri, cilësia e mësimdhënies së stafit vlerësohet nëpërmjet metodave si pyetësorët dhe fokus grupet. Ka vend për përmirësim në këtë drejtim, duke futur si praktikë të punës edhe pyetësorët në bazë lënde ose në bazë pedagogu përgjegjës.</p> <p><i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 21, 22; Ref. Nr. 40, Model Pyetësori i Studentëve Prill 2018.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Është në praktikën e institucionit përfshirja e studnetëve në vlerësimin e input-it akademik që u transmetohet në auditor. Gjatë intervistave që ruajnë anonimatit e studentëve, ata japin vlerësimin e tyre për çështje të lidhura me procesin e mësimdhënies. Edhe takimet në kuadër të funksionimit të Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve studentët shprehin shqetësimet e tyre në prani të një anëtari Zyrës së Këshillimit dhe koordinatorit të programit ose një përgjegjësi të një gruplëndësh. Po kjo zyrë organizon këshillime individuale që ruajnë anonimatit e studentit mbi ecurinë e studimeve.</p> <p><i>Ref. Nr. 40.1, Model Raporti i Fokus Grupeve të Studentëve; Takimi me studentët e këtij programi.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit pasi përpunohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) i raportohen Rektorit të Universitetit dhe më pas publikohen online në faqen web të institucionit në hapësirën Rreth Universitetit- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë-Raportet/ <a href="http://ust.edu.al/raportet/">http://ust.edu.al/raportet/</a>.</p> <p><i>Ref. Nr. 40.3, Model Përcjellje Raporti të punës së NJSBC-së për muajin prill te Rektori i Universitetit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Fakulteti shqyrton me kujdes raportet e përfuara përmes mekanizmave vlerësues dhe merr masa që të bëjë këshillime individuale me personelin akademik, në rast se në raport evidentohen problematika në lidhje me procesin e mësimdhënies. Edhe pas procesit të inspektimit të procesit mësimor, në rast parregullsish jepet këshillim për personelin akademik dhe në rast shkeljesh të përsëritura jepen masa ndëshkimore.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, esetë, etj. Institucioni merr masa që programet e lëndës të ndërtohen mbi bazën e të gjithë elementeve në rregullore, po kështu edhe procesi mësimor të zhvillohet mbi bazën e tyre.</p> <p>Sipas planit mësimor të vënë në dispozicion në Tabelat përmbledhëse rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 232 orë leksione</li> <li>- 71 orë seminare</li> <li>- 340 orë ushtrime</li> <li>- 75 orë praktka profesionale</li> <li>- 718 orë gjithsej</li> </ul> <p>Pra raporti Teori (240)/Praktika Profesionale(486) rezulton 32% me 68%</p> <p><i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 39.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Elementët e studimit të programit të studimit janë të një natyre të shumëllojshme, kjo për shkak të specifikave të arsimit që ofron institucioni. Kjo i mundëson institucionit të adresojë diversitetin e studentëve dhe të nevojave të tyre pedagogjike. Gjithsesi ka vend edhe për metoda alternative që nuk parashikohen në rregullore.</p> <p><i>Ref. Nr. 64, Kalendar i aktiviteteve FVFR 2017-2019.</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni ka përfituar nga pjesëmarrja në programe shkëmbimi si ERASMUS+, duke u ofruar pedagogëve mundësi mobiliteti drejt IAL-ve brenda BE, ashtu si edhe ka mirëpritur lektorë të huaj po në kuadër të programit të mobilitetit të stafit akademik. Ky shkëmbim i ndërsjelltë eksperiencash akademike ka rezultuar në përmirësim të metodave pedagogjike.</p> <p><i>Ref. Nr. 35, Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve;</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik që është ngarkuar me mësimdhënie në programin e studimit ka formimin e duhur arsimor e profesional për fushën. Ashtu siç dëshmon se zotëron kompetencën e duhur për transmetimin e njohurive duke përzgjedhur midis formave tradicionale e alternative të mësimdhënies.</p> <p><i>Ref. Nr. 24, Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit/ Cilësia në mësimdhënie.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Marrja e feedback-ut të studentëve në mënyrë periodike përmes focus grupeve dhe takimeve e këshillimeve individuale ose në grup, ndër të tjera bëhet me qëllim përmirësimin e metodave të mësimdhënies në frymën e sugjerimeve e propozimeve të ardhura nga studentët. GVJ vëren se feedback-u i studentëve do të ishte më i plotë po të administroheshin pyetësorët për pedagogët ose lëndët, në mënyrë specifike.</p> <p><i>Konstatim i bërë gjatë takimit me përfaqësues të NJSBC.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Orët e leksionet zhvillohen në mënyrë interaktive në formën e prezantimeve PowerPoint. Pas konsultimit me dokumentacionin përkatës, por edhe gjatë vizitës në institucion konstatojmë se çdo sallë leksionesh është e pajisur me logjistikën e nevojshme. Orët praktike zhvillohen në ambiente të pajisura me bazën didaktike për zhvillimin e praktikës.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Çdo program lënde përfshin bibliografinë e detyrueshme dhe atë të rekomanduar. Pedagogët i përzgjedhin titujt e librave, aty ku është e mundur, nga fondi i Bibliotekës së institucionit. Kështu studentët kanë mundësi të punojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë në diskutimet e zhvilluara në orët e seminarit, duke e pasuruar informacionin e marrë gjatë orës së leksionit.</p> <p><i>Ref.Nr.19. Dosja e Syllabuseve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				✓

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Institucioni disponon infrastrukturën e nevojshme mësimore e shkencore për t'u ofruar studentëve një përvojë arsimore cilësore. Në rang programi studimi institucioni përlllogarit 16.932 m <sup>2</sup> sipërfaqe në juridiksionin e tij, që është në përmbushje të plotë të standardit ligjor në fuqi m <sup>2</sup> /student. E gjithë hapësira e dedikuar pastrohet e mirëmbahet nga stafi i punësuar për këtë qëllim.  <i>Ref. Nr. 42, Të dhëna të plota për infrastrukturën; Ref. Nr. 60, VKM 418, datë 10.05.2017, Shtojca 1.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Për realizimin e programit të studimit MP, fakulteti disponon 14 auditore për procesin e mësimit (2 salla leksionesh, 4 seminaresh, 8 laboratore). Sallat e leksionit janë pajisur me logjistikën e nevojshme për realizimin e leksioneve në formën e prezantimeve PowerPoint si PC e projektorë.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Institucioni lehtëson procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies përmes infrastrukturës elektronike që disponon. Studentët dhe personeli akademik përdorin për qëllimet e tyre Sistemin për Menaxhimin e Informacionit të Studentëve. Aksesin në këtë sistem realizohet përmes account-it personal të studentit dhe pedagogut në platformën elektronike online ESSE3. Në account-in e tyre studentët informohen për vlerësimin në notë për çdo lëndë, gjejnë transkriptin e vlerësimeve, mesataret e ponderuara të vlerësimeve, prenotojnë provimet që planifikojnë të japin, gjejnë informacionin e nevojshëm në lidhje me orën, vendin e zhvillimit të provimit, si edhe komunikojnë me pedagogët përkatës. Nga ana e tyre pedagogët përmes account-it personal në portal hedhin vlerësimin në notë, vlerësojnë frekuentimin e studentëve, hedhin programet e lëndëve, si edhe mund t'u komunikojnë studentëve informacione të nevojshme.  <i>Ref. Nr. 42.1, Të dhëna për infrastrukturën/Struktura e Teknologjisë së Informacionit; Konstatim i bërë gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Element i çdo programi lënde është bibliografia e ndarë në literaturë bazë dhe literaturë ndihmëse. Kur këto janë tekste të miratuara mësimore nga Senati Akademik, kopje të tyre duhet t'u vihen në dispozicion studentëve në Bibliotekën e institucionit. Kur literatura në gjuhën shqipe mungon, pedagogu i lëndës zgjedh tituj në gjuhën angleze që janë autoritet për fushën e studimit dhe që

	<p>disponohen në fondin e Bibliotekës. Megjithatë, në këtë rast pedagogu përgatit leksionet në gjuhën shqipe bazuar mbi literaturën në gjuhën e huaj. Në kuadër të Paktit me Universitetin, Grupi i Punës për Literaturën, pas propozimeve të marra nga pedagogët ka përpiluar një listë përfundimtare me tituj të librave me zë të fushës të cilët do të përkthehen në gjuhën shqipe. Institucioni ka parashikuar një zë në buxhet për të mbuluar shpenzimet e përkthimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e institucionit është një hapësirë prej 250 m<sup>2</sup> ku janë vendosur 48 vende leximi. Orari i punës së Bibliotekës është 8:00-15:00, nga e hëna deri të premten. Fondi i Bibliotekës numëron 1669 tituj. Siç parashikohet në Rregulloren e Brendshme të Administratës, punonjësi i Bibliotekës bën skedën e titujve sipas Standardit Ndërkombëtar të Përshkrimit Bibliografik (ISBD), që bën të mundur katalogimin e titujve në katalogun online, që aksesohet përmes programit KOHA. Çdo vit një zë i shpenzimeve i dedikohet pasurimit të fondit të Bibliotekës.</p> <p><i>Ref. Nr. 45, Lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë (hard copy dhe e-book), të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit; Ref. Nr. 62, Rregullore e Brendshme e Administratës, neni 11; Ref. Nr. 49.2.4, Mbi miratimin e propozimit për detajimin e të ardhurave, Vendim i Senatit, Nr. 15, datë 01.03.2019.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në kuadër të Paktit për Universitetin, studentë dhe pedagogë kanë akses falas në Bibliotekën online U-library. Institucioni ka marrë masa për njoftimin dhe trajnimin e studentëve dhe pedagogëve për përdorimin e kësaj biblioteke elektronike. Ndër objektivat e fakultetit për vitin 2020-2022 është abonimi në bibliotekën online Pubmed, që të jetë e aksesueshme nga personeli akademik dhe studentë. Buxheti i planifikuar nga njësia bazë për këtë zë është miratuar.</p> <p><i>Konstatim i bërë gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit; Ref. 4.1, Deklarata e Misionit të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Objektivat 2020-2022, pika 2.1.2.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Studentët kanë hapësirën e nevojshme didaktike për përmbushjen e detyrimeve të tyre akademike. Ambientet e Bibliotekës janë të pajisura me PC të lidhur me Internet që mund të shfrytëzohet nga studentët për bërjen e detyrave të kursit. Po kështu, edhe infrastruktura tjetër në funksion të mësimdhënies, si palestra, hapësirat laboratorike janë të aksesueshme nga studentët për qëllime didaktike.</p>



<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p> <p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Një pjesë e pedagogëve shfrytëzojnë platforma online si ResearchGate në mbështetje të veprimtarisë së tyre në mësimdhënie dhe punës kërkimore-shkencore.</p> <p>Çdo anëtar i personelit akademik efektiv është i pajisur me PC. PC-të e të gjithë institucionit janë të lidhur mes tyre përmes rrjetit LAN, që mund të përdoret për komunikim të brendshëm mes punonjësve të institucionit. Gjithashtu edhe PC-të në mjediset e Bibliotekës janë të lidhur në rrjetin LAN, që mund të shfrytëzohet nga pedagogët si mjet komunikimi me studentët, si p.sh. vënia në dispozicion e materialeve didaktike (leksioneve). Adresa e email-it @ust.edu.al është një tjetër mënyrë për komunikimin zyrtar të brendshëm mes punonjësve të institucionit.</p>								
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Studentët e programit MP në Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi që plotësojnë kriteret e përcaktuar në Rregulloren për mbrojtjen e diplomës, kanë të drejtë të zgjedhin temë diplomë për të shlyer detyrimet përmbyllëse të studimeve. Zyra e këshillimit të karrierës siguron u jep asistencën e nevojshme studentëve për procesin e diplomimit. Me zgjedhjen e udhëheqësit dhe përzgjedhjen e temës në konsultim me të, përgjegjësia ligjore për asistimin e procesit i kalon udhëheqësit.</p> <p><i>Ref.Nr.5.1. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Një ndryshim në Rregulloren e Universitetit të Sporteve të Tiranës, Neni 62, pika 1, 2 .</i> <i>Ref.Nr.10. Rregullore e Diplomimit, Neni 1 pika 2, 4, 6.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="630 1131 818 1198">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="818 1131 1031 1198">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1031 1131 1243 1198">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1243 1131 1437 1198">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				✓
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			✓						

<p><b>Standardi III.4</b></p> <p><b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë autonomenë përbërjen e institucionit. GVJ konstaton në bazë të intervistave të bëra me zyrën e cilësisë se si pjesë e veprimtarisë së saj është vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozimi i ndryshimeve për përmirësime të nevojshme. Kjo zyrë për hartimin e planit vjetor të punës koordinon veprimtarinë me Rektorin për të marrë njohje mbi prioritetet, strategjinë e zhvillimit të UST dhe të reflektojë mbi veprimtarinë e saj.</p> <p><i>Ref. Nr. 37.1, Plan Veprimi Kalendarik i NJSBC .</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron. Ai përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore. Gjithashtu drejtuesi i departamentit ndjek hartimin e programeve mësimore. Në bashkërendim me zëvendësdekanin, drejtuesi i departamentit si koordinator i programit ndjek zhvillimin e orëve të mësimit nga personeli akademik, si edhe inkurajon studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar.</p> <p><i>Ref.Nr.5. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 22, Pika 4</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Personelit akademik i kërkohet të shfrytëzojë maksimalisht metodat e reja inovative në procesin e mësimdhënies. Është detyrim për stafin akademik që orët e leksionit t'i zhvillojë duke përdorur metodat interaktive të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni e ka në vëmendje të vazhdueshme mbështjen e stafit në fushën e kërkimit shkencor. Përveç takimeve trajnuese, tashmë është në praktikën e institucionit organizimi i konferencave shkencore ndërkombëtare në rang universiteti dhe në rang njësie kryesore që ofron programin e studimit. Po kështu Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit organizon konferenca shkencore kombëtare/ndërkombëtare. Konstatohet se ka një angazhim domethënës nga ana e stafit në drejtim të kërkimit shkencor. Në të gjitha këto organizime stafi akademik efektiv merr pjesë pa asnjë lloj detyrimi financiar.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Personelit akademik i institucionit i jepet mundësia të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, kryesisht përmes periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partere, në kuadër të programeve Erasmus+, si edhe përmes lektorëve të ftuar në kuadër të veprimtarive kualifikuese për stafin.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik është përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe përmirësimin e mësimdhënies. Përgjegjësia fillon që me hartimin e programit të lëndës/silabit, duke përfshirë edhe metodat e mësimdhënies të parashikuara për secilën temë. Personeli akademik është përgjegjës për përzgjedhjen e metodave të reja të mësimdhënies. Ndihmësit mësimorë mund të asistojnë pjesëtarë të stafit akademik, kur këta të fundit kanë vështirësi në adoptimin e zhvillimeve teknologjike.</p> <p><i>Konstatim i bërë gjatë takimit me pedagogët e programit</i></p> <p><i>Ref. Nr. 35, Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve.</i></p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjatë takimit me pedagogët GVJ konstaton se personelit akademik i garantohet ushtrimi i lirisë akademike në drejtim të testimit të metodave të reja në funksion të mësimdhënies. Për shkak se programi i lëndës është subjekt rishikimi i përvitshëm, është e mundur që të reflektohen përshtatjet dhe ndryshimet e nevojshme, në përputhje me rezultatet e testimit të metodave të reja gjatë procesit të mësimdhënies. Diskutimet në mbledhjet e departamentit shfrytëzohen si hapësirë për raportuar rezultatet e një metode të caktuar, me synim që kjo eksperiencë pozitive të ndahet me kolegët dhe të shfrytëzohet edhe prej tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Në kuadër të shkëmbimit të ideve në përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, Institucioni realizon shkëmbime periodike të stafit akademik në kuadër të programit Erasmus+.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>✓</p>

<p><b>Standardi III.5</b></p>	
<p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Rregullorja e Programit parashikon modalitetin e vlerësimit. Procesi i vlerësimit përfshin një shumatore të vlerësimit të vazhdueshëm (testime, provime të ndërmjetme etj) dhe atij përfundimtar.</p> <p>Pesha specifike e komponentëve të vlerësimit është e përcaktuar në Rregulloren e Programit, në Nenin 29 ku thuhet [cit]: <i>Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e syllabusin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve.... Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet a) me provim më shkrim, me gojë ose i kombinuar; b) me detyra kursi, projekte, postera; c) bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.</i></p> <p>Edhe në Nenin 30 thuhet [cit]: <i>Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur ka shlyer detyrimet që lidhen me atë lëndë, të parashikuara për shlyerjen e programit mësimor, program dhe syllabus.</i></p> <p>GVJ konstaton se elementet dhe mënyra e vlerësimit pasqyrohen në syllabuset e lëndëve/moduleve për vitin akademik 2017-2018, në të cilat pasqyrohen me imtësi vlerësimet e vazhdueshme të studentit. Studentët mund</p>

	<p>të përfitojnë edhe nga asistenca e ofruar për ta nga koordinatori i programit dhe Zyra e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve për t'u informuar.</p> <p>Modeli i vlerësimit të studentit në syllabuset e 2017-2018, ka dy variante në lëndë të ndryshme:</p> <table border="1" data-bbox="603 421 1414 689"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Vlerësimi gjatë gjithë vitit</th> <th colspan="2">Logaritja në %</th> </tr> <tr> <th>Varianti 1</th> <th>Varianti 2</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Testimi i parë i ndermjetem</td> <td>35</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Testimi i dytë i ndermjetem</td> <td>-</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Testimi përfundimtar</td> <td>45</td> <td>40</td> </tr> <tr> <td>Vep. student. në grup, Individ. Ese, Detyra.</td> <td>20</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej:</b></td> <td><b>100</b></td> <td><b>100</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Syllabuset e lëndëve për vitin 2019-2020 nuk e kanë këtë element të pasqyruar; pavarësisht kësaj në sekretarinë mësimore u konstatua që të gjithë pedagogët i vlerësojnë studentët edhe gjatë vitit.</p> <p>GVJ rekomandon q t'i pasqyrojnë ato, në syllabusin e integruar në lëndë të përbërë nga dy module.</p> <p><i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 50, 61; Konstatim i bërë gjatë takimit me studentët e programit.</i></p> <p><i>Ref.Nr.19.1 Model Syllabi Lende, Modeli i nje lende ku ne brendesi paraqiten dy modulet e tij, perkatesisht Terapia e Levizjes Rehabilitim dhe Gjymnastike Posturale.</i></p>				Vlerësimi gjatë gjithë vitit	Logaritja në %		Varianti 1	Varianti 2	Testimi i parë i ndermjetem	35	20	Testimi i dytë i ndermjetem	-	20	Testimi përfundimtar	45	40	Vep. student. në grup, Individ. Ese, Detyra.	20	20	<b>Gjithsej:</b>	<b>100</b>	<b>100</b>
Vlerësimi gjatë gjithë vitit	Logaritja në %																							
	Varianti 1	Varianti 2																						
Testimi i parë i ndermjetem	35	20																						
Testimi i dytë i ndermjetem	-	20																						
Testimi përfundimtar	45	40																						
Vep. student. në grup, Individ. Ese, Detyra.	20	20																						
<b>Gjithsej:</b>	<b>100</b>	<b>100</b>																						
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Konstatohet se është praktike pune e rregullt që pedagogu i lëndës të informojë studentët për elementet e programit të lëndës në orën e parë të seminarit.</p> <p>Pedagogu vë në dispozicion studentëve edhe programet në format hard copy ose komunikon me ta përmes platformës ESSE3.</p> <p><i>Ref.Nr.19.1. Model Programi i Lëndës Terapia Lëvizjes Rehabilitim.</i></p>																							
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Për shkak të specifikave të programit, për lëndët që përfshijnë orë praktike rregullorja parashikon testimin me shkrim dhe testimin praktik. Pësha e të dy vlerësimeve në përqindje është po kështu e parashikuar në Rregullore. Pësha e vlerësimit përfundimtar është tregues në një shkallë më të plotë i njohurive dhe kompetencave të fituara.</p> <p><i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 50, pika 1, neni 61, pika 7.</i></p>																							
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>																				
			✓																					

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm përgjatë semestrit. Vlerësimi përfundimtar është rezultat i vlerësimeve të vazhdueshme të ponderuara sipas peshës specifike që zënë në totalin e vlerësimit. Në sekretarinë mësimore u konstatua që të gjithë pedagogët i vlerësojnë studentët gjatë vitit dhe vlerësimi përfundimtar është i ponderuar</p> <p>Specifikat e programit të studimit të ndërtuar mbi lëndë teorike dhe praktike në raportin 32%:68%, lënë pak vend për sisteme elektronike të testimit. Për shmangien e abuzimeve, njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit merr masa të monitorojë procesin e testimit dhe të rritë transparencën. Publikimi i rezultateve të vlerësimit në platformën ESSE3 dhe transmetimi i tyre në kohë reale të studentët është një aspekt që i kontribuon transparencës.</p> <p><i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 61, pika 7.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se procedura e ndjekur për procesin e provimit është në përputhje të plotë me udhëzimet ligjore në fuqi. Procesi i provimit administrohet nga komisioni i provimit i përbërë nga së paku 2 pedagogë dhe i kryesuar nga titullari i lëndës. Ky komision është përgjegjës për zhvillimin korrekt të provimit që nga dhënia e tezës deri në përfundim të tij.</p> <p><i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 54, pika 2.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Për shmangien e abuzimeve, Rregullorja e institucionit parashikon që testimet me shkrim të bëhen në fletë të sekretuara. Departamenti përgjegjës për programin e studimit merr masa për realizimin e procesit të sekretimit.</p> <p><i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 54, pika 6; Ref. Nr. 63, Model teze e sekretuar.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Pas marrjes në dorëzim dhe shqyrtimit të detyrave të kursit nga pedagogu i lëndës, ky i fundit vlerëson punimin sipas një sistemi pikëzimi, shoqëruar edhe me komentet përkatëse për t'i evidentuar studentit pikat e dobëta dhe si mund t'i përmirësojë ato. Studenti ka mundësi të njihet me vlerësimin e pedagogut, ashtu si edhe me komentet shoqëruese. Kur paraqitja e detyrave të kursit bëhet në formën e prezantimeve orale, pedagogu mban shënime gjatë prezantimit në regjistrin e tij personal dhe ia bën të ditura ato studentit në fund të prezantimit, përfshirë këtu edhe vlerësimin me pikë.</p>

	Ngjashëm edhe korrigjimi i tezave me shkrim përban shenjime të dukshme të përgjigjeve të sakta dhe përgjigjeve të gabuara, shoqëruar me vlerësimin përkatës. Studenti edhe në këtë rast ka mundësi të njihet me vlerësimin e pedagogut.
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Mbarëvajtja e provimit mbikëqyret nga komisioni i provimit, dhe nga personeli ndihmës mësimor i departamentit përgjegjës për programin ose nga një departament tjetër.  Në auditor nuk lejohet prania e personave të tjerë të paautorizuar. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur dhe nuk lejohet përdorimi i tyre për asnjë lloj qëllimi. Kopjimi, komunikimi me studentë të tjerë ndëshkohet me përjashtim nga provimi dhe me vlerësimin si mbetës.  Për shmangien e plagjiaturës, pedagogu i lëndës pasi merr në dorëzim esetë/detyrat e kursit edhe në formë elektronike mund të shfrytëzojë sistemet antiplagjiaturë që ofrohen pa pagesë.  <i>Ref Takimi me pedagogëte programit</i>
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentëve. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda afateve të përcaktuara në rregullore, që parashikon edhe afatet për shqyrtim të vlerësimit nga ana e studentit dhe reklamimit të pakënaqësive në lidhje me të.  <i>Ref. Nr. 5.1, Një ndryshim në Rregulloren e Universitetit të Sporteve, Neni 50/1, pika 3.</i>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Platforma online ESSE3 i mundëson studentit të informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit. Pas kësaj, studenti ka të drejtën që brenda afatit të përcaktuar në rregullore (48 orë nga komunikimi i rezultatit) të sqarojë çdo paqartësi ose pretendim të mundshëm që ka lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, printohet "Pasqyra e rezultateve", firmoset nga komisioni i provimit dhe dorëzohet në Sekretarinë Mësimore.  <i>Ref. Nr. 5.1, Një ndryshim në Rregulloren e Universitetit të Sporteve, Neni 50/1, pika 3.</i>
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, Rregullorja e institucionit parashikon që studenti të përpilojë një ankesë me shkrim në lidhje me vlerësimin, dhe ia paraqet atë drejtuesit të departamenti. Kur drejtuesi i departamentit, në bashkëveprim me komisionin e vlerësimit, e ka të pamundur të zgjidhë ankesën, vë në dijeni dekanin. Pasi ngre komisionin ad-hoc për verifikimin, ky komision vendos për dhënien e një vlerësimi përfundimtar, apo për rihvillim të provimit. Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe

	dorëzohen në Sekretarinë Mësimore. Një kopje e praktikës ruhet në arkivën e Dekanatit. <i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 57.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit është ndërtuar mbi logjikën e ndërthurjes së koncepteve teorike bazë të nevojshme për fushën e studimit, njohuri të karakterit të formimit të përgjithshëm dhe aftësive profesionale të veçanta për specialistët e fushës.</p> <p>Krahas drejtimit madhor akademik, programi i studimit jep mundësinë e një formimi në fusha të veçanta të karakterit social-human, të komunikimit e ndërveprimit. Pjesë e kurrikulës së programit të studimit janë lëndë si: Shkenca Sociale në Aktivitet Fizik, Sport, Turizëm Rekreativ, Gjuhë Terminologji - Anglisht, Trajning Personal dhe Disiplinat e Sporteve Individuale Rekreative.</p> <p><i>Ref.Nr.14. Plani mësimor 2019-2020, MP në “Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni -Trajner Fitnessi”.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Si rregull, në seminarin e fundit pedagogu bën përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, dhe përmes një diskutimi të hapur me studentët merr mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Esetë/detyrat e kursit janë një tjetër feedback për analizë të mëtejshme nga pedagogu në lidhje me arritjen e rezultateve të pritshme të mësimnxënies.</p> <p><i>Konstatim i bërë gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik thekson çështjet më të rëndësishme si një orientim për provimin përfundimtar, por edhe si lidhen ato me konceptet që do të përthithë studenti në vijim të studimeve. Pedagogu mund të ndalet më gjatë në elementet që kanë rezultuar më të vështirë për t'u përvetësuar nga studentët gjatë semestrit. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.</p> <p><i>Konstatim i bërë gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit.</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni dhe njësia kryesore që ofron programin e studimit zhvillojnë vazhdimisht leksione të hapura, ku ftohen ekspertë e personalitete të fushave për të ndarë me personelin akademik dhe studentët zhvillimet e fundit në fushën e tyre të eksperitizës, çështje të ltë aktualitetit dhe zhvillimeve të reja në fushën e shkencës dhe teknologjisë. Këto takime zhvillohen si aktivitete ekstrakurrikulare, të hapura për t'u ndjekur nga të gjithë studentët e interesuar dhe personeli akademik.</p> <p><i>Ref. Nr. 64, Kalendar i aktiviteteve FVFR 2017-2019.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Orët e laboratorit dhe të praktikave profesionale zënë një peshë të konsiderueshme në programin e studimit. Orët e seminarit zhvillohen si hapësiradidaktike mbi bazëkompetencash ku student bën ndërthurjen midis orëve të leksionit dhe atyre të kaluara në laborator, në praktikat profesionale ose ne ushtrime. Detyrat që pedagogu u cakton studentëve gjatë orës së seminarit janë forma të mësimdhënies që reflektojnë kompetenca.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Në çdo element të procesit mësimor personeli akademik synon ndërveprimin e studentëve. Gjatë orëve të leksionit, pedagogu sigurohet që studentët të ndihen të lirshëm të diskutojnë për çështjet që trajtohen, madje edhe të shprehin mendimin e tyre kur është e nevojshme. Orët e seminareve konceptohen e zhvillohen si orë diskutimesh e pune në grup, ku studentët angazhohen të analizojnë raste specifike e të parashtrajnë zgjidhjen e tyre.</p> <p><i>Konstatim i bërë gjatë takimit me pedagogët dhe studentët e programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Personeli akademik informohet për zhvillimet më të fundit në fushën e kërkimit shkencor duke marrë vetë pjesë në hulumtim shkencor. Nga ana tjetër personeli akademik nxit dhe përkrah edhe pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari të këtij lloji, duke i bërë studentët pjesë të studimeve të tij ose duke udhëhequr pjesëmarrjen e tyre në sesione poster në takimet shkencore të organizuara nga institucioni.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Institucioni ka si pjesë të vizionit të vet përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor, përmes pjesëmarrjes në aktivitete kërkimore. Objektivi është që studentët, sidomos ata të ciklit të dytë të studimeve të aktivizohen në projekte shkencore si një praktikë e përvitshme. Në konferencën shkencore ndërkombëtare të oragnizuar nga UST, studentët ftohen të marrin pjesë në seksionin dedikuar prezantimeve të studentëve kundrejt asnjë detyrimi financiar. Pjesë nga zëri i grantit për kërkimin shkencor shkon për të mbështetur financiarisht studentët në aktivitete shkencore.</p> <p><i>Ref. Nr. 3, Plani Strategjik UST 2016-2020, Objektivat, Kërkimi shkencor, f. 17; Ref. Nr. 49.4, Mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare.</i></p>



<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Shkëmbimet e personelit akademik dhe mobiliteti i studnetëve drejt universiteteve partnere perëndimore në kuadër të projekteve Erasmus+, janë dëshmi se institucioni implementon metoda mësimdhënieje të ngjashme me ato të aplikuara në instiucione partnere, qofshin këto edhe nga vendet e Komunitetit Evropian.  <i>Ref. Nr. 35, Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi III.8</b>				
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.  <b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Njësitë përgjegjëse kanë në dispozicion për realizimin e praktikave laboratorike dhe profesionale një seri ambientesh specifike sipas lëndëve/moduleve përkatëse.  Në kuadër të realizimit të praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më bashkëkohore, Institucioni ka nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me Poliklinikën Gjermane dhe me Shoqatën e Rehabilitimit Fizik për Personat me Aftësi të Kufizuara.  <i>Ref.Nr.42.2. Shkresa Nr. 1584 Prot, më. 06.11.2018. Të dhëna për infrastrukturën, Laboratorët.</i>  <i>Ref. Nr.35. Marrëveshja me Poliklinikën Gjermane,</i> <i>Ref.Nr. 35. Shoqatën e Rehabilitimit Fizik për Personat me Aftësi të Kufizuara.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Programet e studimeve të ciklit të dytë në MP Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi përmbajnë praktikrat profesionale të cilat aftësojnë studentët si specialist të edukimit fizik e sportit (Trajner Fitnesi) , në kontekstin praktik profesional, të cilat ekuivalentohen me 5 kredite.  <i>Ref.Nr.14. Plani mësimor 2019-2020, MP në “Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi”Neni 27 .</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi III.9</b>				
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>				

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit parashikon mundësinë e provimit përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës si alternativa për shlyerjen e detyrimeve përmbyllëse. Kur studenti kualifikohet dhe zgjedh të mbrojë një temë diploma. Rregullorja e diplomimit është dokumenti zyrtar që rregullon çdo procedurë që ndiqet nga aplikimi dhe miratimi i temës së diplomës, te procesi i udhëheqjes së saj, deri te formati i dorëzimit dhe mbrojtja përpara komisionit. Ky informacion i vihet në dispozicion studentit në hapësirën elektronike didaktike.</p> <p>Departamenti përgjegjës për programin e studimit miraton listën e udhëheqësve të temave të diplomës. Një muaj nga dita e fillimit të vitit akademik, departamenti u bën të njohur studentëve të vitit të fundit temat e diplomave. Brenda datës 20 dhjetor caktohen temat, udhëheqëit dhe plani i veprimit të punimit të diplomës për çdo student. Po kështu departamenti përgjegjës për administrimin e provimit përfundimtar harton listën e temave që do të përfshihen në provim, të cilat afishohen në stendën e informimit për studentët.</p> <p><i>Ref.Nr.5. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 63, pika 1a, e, f, g.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në hartimin e tezës, komisioni i posaçëm ndërton pyetje rreth çështjeve tashmë të përzgjedhura nga disiplina të kategorisë A dhe B, në raportin 30:70 mes tyre. Teza e provimit hartohet sipas formatit të miratuar nga dekani.</p> <p><i>Ref.Nr.10.1. Model Teze e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Punimi i temës së diplomës kalon nëpër tri etapa të parashikuara në rregullore. Udhëheqësi i temës siguron asistencë për studentin përgjatë etapave. Studentët që përgatiten për provimin përfundimtar kanë të drejtë të konsultohen me pedagogët e lëndëve përkatëse në oraret e këshillimit të përcaktuara nga pedagogu.</p> <p><i>Ref.Nr.10. Rregullore e Diplomimit, Neni 3.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme laboratorike që shfrytëzohet për procesin mësimor. Këto hapësira mund të shfrytëzohen edhe nga studentët për qëllime studimore nën mbikëqyrjen e pedagogut udhëheqës ose ndihmësit mësimor që ka në ngarkim laboratorin.</p> <p><i>Ref.Nr.42.2. Të dhëna për infrastrukurën, Labororët.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë</p>	<p>GVJ në takimin me drejtues të departamentit dhe me studentët u informua mbi metodikën e udhëheqjes së studentëve për punimin e tezës së diplomës. Qysh në fillim të vitit nga departamenti afishon dhe ju bëhen me dije studentëve temat që mund të zgjedhin për tezë diploma si dhe emrat e pedagogëve që mund ti udhëheqin. Kanë të</p>

<p>për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>drejtë të futen në provimin përfundimtar të diplomës të gjithë ata student që kanë shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor.</p> <p>Pasi aprovohen temat dhe udhëheqësit përkatës pedagogu udhëheqës dhe studenti bëjnë seanca të konsultimit të herë pas hershme ku diskutohet mbi: metodologjinë e punimit, gjetjen dhe përpunimin e të dhënave nga pikëpamja statistikore dhe hartimin e punimit përfundimtar të diplomës.</p> <p>Udhëheqësi pasi sigurohet që punimi përmbush kriteret e cilësisë në drejtim të përmbajtjes dhe formës, miraton dhe aprovon që punimi të prezantohet para komisionit duke e firmosur.</p> <p>Vlerësimi pozitiv i punimit të diplomës kryhet nga komisionet e posaçme përmes një sistemi pikëzimi, nga 50 deri 100 pikë, që më pas konvertohet në vlerësim me notë.</p> <p><i>Ref.Nr.10. Rregullore e Diplomimit, Neni 5, pika 3.</i></p> <p><i>Ref. Nr.10.1. Ibid., Shtojca 4, Shtojca 5, f.22-24 (Ref. Nr. 10); Model Tezë e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit MP Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnessi, pajisen me diplomën përkatëse. Formatin dhe përmbajtjen e Diplomës dhe Supplementit të Diplomës hartohen në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p><i>Ref.Nr.5. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 67, pika 1.</i></p> <p><i>Ref. Nr. 5. Ibid., Neni 66 pika 3,4.</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studentit të diplomuar i lind e drejta të kërkojë një kopje zyrtare të programit të studimit dhe elementeve përbërës të tij. Gjithashtu, studentit pajiset me Supplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht). <i>Ref.Nr.15.1. Model i Supplementit të Diplomës.</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p>	<p>Në përputhje me politikat e institucionit bëhet arkivimi, ruajtja dhe administrimi i dokumentacionit, për një periudhë pa afat. Përveç dokumentacionit hard copy, institucioni i hedh të dhënat në një databazë të detajuar, dhe i përpunon ato sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				✓

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				✓

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Pas kërkesës për dokumentacionin përkatës dhe pasi e konsultoi atë, GVJ konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore ruan të dhënat e personelit akademik e administrativ dhe i përditëson ato me ndryshimet përkatëse. Dokumentacioni i depozituar prej çdo personeli akademik ruhet sipas formatit të Dosjes Personale të Stafit Akademik.</p> <p><i>Ref. Nr. 11, Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore; Ref. Nr. 23.1, Të dhëna tabelore për Personelin akademik për vitet 2014-2019; Ref. Nr. 44, Formati i Dosjes personale të stafit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>E gjithë procedura e rekrutimit të stafit akademik bëhet konform procedurave të hartuara sipas legjislacionit në fuqi, mbështetur edhe mbi politikat e brendshme institucionale. GVJ konstaton gjatë takimit me zyrën e burimeve njerëzore se manaxhimi i dosjeve të stafit dhe procedurat e rekrutimit janë transparente dhe konform akteve rregullatore në fuqi.</p> <p><i>Ref. Nr. 11.1, Relacion mbi Procedurën e Rekrutimit të Personelit Akademik/Administrativ.</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Procedura e rekrutimit të stafit akademik është e parashikuar në Rregulloren e brendshme të institucionit. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Çdo shpallje për vende të lira të punës për personel akademik publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në gazeta, revista ose televizione në varësi të fondeve të universitetit. Po kështu këto njoftime bëhen publike në faqen zyrtare të universitetit. <i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 25, pika 1,2; Ref. Nr. 11.2, Print Screen i njoftimit të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike.</i></p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja përcakton që kriteret e punësimit të personelit akademik të propozohen nga departamenti përkatës, dhe pas shqyrtimit nga Dekani, t'i përcillen Rektoratit për miratim. Vlerësimi i kandidatave bëhet në bazë të paketës së aplikimit (70%) dhe intervistës (30%). Kriteret e paketës së aplikimit dhe pyetjet e intervistës hartohen në përputhje me specifikat e vendit vakant të shpallur. <i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 25, pika 3,4; Konstatim i bërë gjatë takimit në Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Arkivit.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Nga RVB dhe dokumentacioni plotësues si dhe vizita ne IAL, GVJ konstaton se me rikonstruksionin e godinës së re institucioni ofron mjedise të mjaftueshme e brenda standardeve për zhvillimin e veprimtarisë profesionale të personelit akademik.</p> <p>Kapacitetet infrastrukturore në dispozicion për FVFR, prej 8 zyrash stafi akademik efektiv (mestarisht 3 poste pune për çdo zyrë), të pajisura me PC për çdo anëtar të stafit, me sistem kondicionimi e ndriçimi sigurojnë për stafin mjedis të përshtatshëm pune e mundësish të barabarta për kryerjen e detyrave profesionale. <i>Ref. Nr. 42, Të dhëna të plota për infrastrukturën.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Nga RVB dhe dokumentacioni plotësues GVJ konstaton se cdo vit në detajimin e grantit, konstatojmë se UST parashikon një zë për kërkimin shkencor, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë (financim i projekteve shkencore, pjesëmarrje në konferenca, publikime shkencore), por edhe në mënyrë të tërthortë përmes investimeve në infrastrukturën laboratorike që mund të shfrytëzohet nga pedagogët për zhvillim të mëtejshëm shkencor e profesional. Ky fond mbulon shpenzimet për pagesën e tarifës së pjesëmarrjes në konferencë dhe shpenzimet e udhëtimit. Gjithashtu insitucioni nuk u bën pedagogëve asnjë ndalesë në pagë për ditët e punës që u merr pjesëmarrja në konferencë. Fondi për botimin e revistës shkencore të UST-së dhe shpenzimet për organizimin e konferencave shkencore kombëtare/ ndërkombëtare, që të gjitha mbulohe nga buxheti i UST-së. Marrëveshjet e bashkëpunimit që nënshkruan për shkëmbimin e stafit janë gjithashtu tregues i mbështetjes që institucioni siguron për kualifikimin e stafit, në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit.</p> <p><i>Ref. Nr. 49.2.4 Mbi miratimin e propozimit për detajimin e të ardhurave, Vendim i Senatit, Nr. 15, datë 01.03.2019; Ref. Nr. 49.2.5, Mbi shtesa në vendimin Nr.3, Vendim i Senatit, Nr. 21, datë 10.04.2019; Ref. Nr. 49.2.6, Mbi miratimin e propozimit për shtesa në detajimin e të ardhurave, Vendim i Senatit, Nr. 29, datë 05.07.2019; Ref. Nr. 49.2.8, 49.2.8, Mbi shtesa në vendimin Nr.15, Vendim i Senatit, Nr. 37, datë 14.10.2019.</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ konstaton se për rekrutimet e reja në përbërjen e personelit akademik efektiv, institucioni siguron përmes zyrës së IT-së asistencën e nevojshme në formën e trajnimeve për përdorimin e platformave elektronike që ofron institucioni për programin e studimit. Institucioni merr masa që pedagogë të caktuar dhe personeli ndihmës mësimor të trajnohet për përditësimin me protokollet laboratorike në funksion të procesit të kërkimit shkencor dhe procesit të mësimdhënies.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ konstaton se Logjistika e mjaftueshme në burime njerëzore, përzgjedhja e tyre sipas kriterëve të përcaktuara ligjore dhe ato specifike për programin e studimit, dhe politika që ndjek njësia kryesore dhe njësia përgjegjëse për programin e studimit në shpërndarjen e ngarkesës mësimore në bazë ekspertize janë disa tregues domethënës të angazhimit optimal të burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së objektivave të programit MP.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>✓</p>

<p><b>Standardi IV.3</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga RVB dhe dokumentacioni plotësues GVJ konstaton që si një institucioni universitar i ndërtuar dhe i rikonstruktuar përgjatë viteve, në bazë të specifikave të programeve të studimit që ofron, ai garanton infrastrukturën e nevojshme dhe cilësore për procesin e mësimdhënies. Sallat e leksioneve, të seminareve, labororet, terrenet sportive, biblioteka, etj, vihen plotësisht në dispozicion të procesit mësimor. <i>Ref. Nr. 42, Të dhëna të plota për infrastrukturën; Ref. Nr. 42.2, Të dhëna për infrastrukturën, Labororet.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita ne IAL GVJ konstatoi që hapësirat mësimore janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme didaktike për zhvillimin e leksioneve, seminareve, laboreve dhe orëve praktike. Sallat e leksioneve janë pajisur me PC dhe projektor për prezantimin e e leksioneve me PowerPoint. Laboratori i IT dhe Linguistikës janë pajisur secili me nga 35 poste studimi me PC. Të gjithë kompjuterët janë lidhur në rrjet.</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se laboratorët e ndryshëm si ai i anatomisë, laborator i fizioterapisë, laborator i rehabilitimit sportiv, laborator i biomekanikës, laborator biokimik, laborator i vlerësimit postural, salla e fitnessit, salla e dansit, palestra e gjimnastikës, etj., janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e një procesi mësimor që përmbush objektivat formuese të lëndës specifike dhe të programit të studimit në përgjithësi.</p> <p>Laboratori i Informatikës është i pajisur me 36 kompjutera PC me parametra teknike të standardeve bashkëkohore, ku janë instaluar të gjithë programet e nevojshme për të mundësuar zbatimin e programeve lëndore.</p> <p>Kjo hapësirë shfrytëzohet edhe për aktivitete trajnuese, si edhe vihet në dispozicion të studentëve për realizimin e detyrave të kursit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Falë përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit është siguruar infrastrukturë për laboratorët e fizioterapisë në formën e akt-dhurimit. Edhe në kuadër të bashkëpunimeve në programet TEMPUS është përfituar bazë materiale për infrastrukturën e laboratorëve si ai i biomekanikës, laborator i lingistikës, etj. Në përputhje me politikat financiare të institucioni çdo vit planifikohen nga granti shpenzime në drejtim të pajisjeve laboratorike. <i>Ref. Nr. 35, Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b></p>				
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Bibliotekë GVJ konstaton se Biblioteka e UST-së është një hapësirë brenda mjediseve të universitetit. Ka një hapësirë prej 258.4 m<sup>2</sup> me 48 vende leximi. Përveç se hapësirë leximi, biblioteka shfrytëzohet nga studentët edhe për infrastrukturën kompjuterike përgjatë ditës në funksion të realizimit të detyrimeve të programit të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha</p>	<p>Nga RVB, dokumentacioni plotësues dhe nga vizita në bibliotekë, GVJ konstaton që Fondi i librave të bibliotekës numëron 1.669 tituj librash, që përfshijnë: libra në gjuhën shqipe të miratuara si tekste mësimore nga Senati Akademik; libra të fushës në gjuhë të huaj, kryesisht libra në gjuhën angleze nga shtëpia botuese Human Kinetics, shtëpia botuese lider në fushën e programit të studimit;</p>			

moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	libra në gjuhë të tjera; revista shkencore; kopje të disertacioneve të të personelit akademik të UST-së.			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Nga RVB, dokumentacioni plotësues dhe nga vizita në bibliotekë, GVJ konstaton U-Library është aktualisht e vetmja platformë online që shfrytëzohet nga studentët dhe pedagogët për të aksesuar, shkarkuar libra mësimore në format pdf, artikuj shkencorë, revista shkencore, etj. Studentët e pedagogët mund ta aksesojnë këtë bibliotekë pa pagesë përmes adresës së emailit të siguruar nga institucioni.</p> <p>Biblioteka e UST-së është e pajisur me PC, të lidhur në rrjetin LAN që përdoren nga studentët për të kërkime të mëtejshme në fushën e tyre të studimit, për të marrë materiale didaktike nga pedagogët e tyre, të hedhura në rrjetin e brendshëm.</p> <p>Fondi i Bibliotekës shtohet çdo vit prej buxhetit të institucionit të planifikuar për zërin Libra.</p> <p><i>Ref. Nr. 49.2.4, Mbi miratimin e propozimit për detajimin e të ardhurave, Vendim i Senatit, Nr. 15, datë 01.03.2019; Ref. Nr. 45, Lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë (hard copy dhe e-book), të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Orari i Bibliotekës është 08:00-15:00, gjatë të cilit mund të shfrytëzohet nga studentët e të gjitha cikleve të studimit.</p> <p>Këshillohet në të ardhmen zgjatja e shërbimit në bibliotekë, për tu përshtatur me orarin e programit të studimit të MP (14:00-20:00).</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Nga RVB, dokumentacioni plotësues dhe nga vizita në sekretarinë mësimore, GVJ konstaton se UST administrojnë të gjithë informacionin e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim përmes sistemit UMIS, që aksesohet përmes platformës ESSE3 dhe ku ruhen, administrohen e përpunohen dhënat e studentit dhe rekordet akademike ndër vite.</p> <p>Sistemi për Menaxhimin e Informacionit është i aksesueshëm edhe</p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>nga personeli akademik që e përdor atë për aktivitetin në kuadër të procesit të mësimdhënies; i mundëson studentit të përditësohet në kohë reale me të dhënat që pedagogu hedh në sistem si vlerësime, frekuentim, program/silabe dhe komunikime në formë mesazhesh tekst. Institucioni është në proces të implementimit të një arkive digjitale për administrimin e dokumentacionit të të gjitha drejtorive të UST-së. Aktualisht drejtoritë funksionojnë përmes krijimit të bazave të të dhënave lokale, në format Word dhe Excel.</p> <p>Sistemi aktual i Menaxhimit të Informacionit ofron funksionalitetet e nevojshme për stafin akademik, administratën (sekretarinë mësimore) dhe studentët për administrimin e të gjithë ciklit akademik të studentit: si regjistrimi i program/syllabus të kurseve, vlerësimet deri në diplomim, gjithashtu transferimet nga njëri universitet në tjetrin. <u>Funksionalitetet didaktike</u> përfshijnë: strukturën akademike, menaxhimin e karrierës së studentit si dhe administrimin e provimeve dhe diplomimin. <u>Funksionalitetet për sekretarinë</u> përfshijnë: pranimin dhe regjistrimin, menaxhimin e studentëve hyrës dhe dalës. <u>Funksionalitetet për aspektet financiare</u> të programit të studimit përfshijnë: menaxhimin e tarifave; bursat; periudhat financiare etj.</p> <p><i>Ref. Nr. 46 Udhëzues për përdorimin e SIMS.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Një nga funksionet e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit është komunikimi dhe shkëmbimi i materialeve didaktike dhe informacionit në formë njoftimesh mes pedagogut dhe studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i Menaxhimit të Informacionit siguron monitorimin e mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, sidomos në lidhje me administrimin e provimeve dhe hedhjes së vlerësimeve. Kjo i kontribuon shmangies së vonesave dhe rritjes së transparencës. Nga ana tjetër, pedagogët mund të përdorin të dhënat e hedhura në sistem për përpunime të mëtejshme statistikore.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Institucioni ka në administrim faqen zyrtare <a href="http://www.ust.edu.al">www.ust.edu.al</a> dhe në përputhje me politikat e transparencës dhe politikat e privatësisë të hartuara konform legjislacionit në fuqi, përcakton se cilat informacione e dokumente do të bëhen publike përmes faqes. Përmbajtja e faqes ofrohet në gjuhën shqipe. Platforma e U-Transparencës është një tjetër hapësirë elektronike ku institucioni shfaq informacione dhe vendime të ndryshme që merr. Llogaritë në rrjetet shoqërore janë gjithashtu mundësi informimi për njoftime të ndryshme. <i>Ref. Nr. 48, Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale; Ref. Nr. 48.1, Politikat e Privatësisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>




standardit				✓
------------	--	--	--	---

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit përkatës, GVJ konstaton se shpenzimet për program të dytë studimi mbulohen nga tarifat e shkollimit. Të ardhurat e gjeneruara nga institucioninë formë tarifash shkollimi, donacionesh, sponsorizimesh, etj., shkojnë gjithashtu në mbështetje të programit të studimit.</p> <p><i>Ref. Nr. 50.1, Mbi miratimin e propozimit për detajimin e grantit, Vendim i Senatit, Nr.3, datë 10.01.2019; Ref. Nr. 49.5, Tarifat e shkollimit për program të dytë studimi Vendim i Senatit, Nr. 31, datë 05.07.2019; Ref. Nr. 50, Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit 2017-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një progra studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin literaturës e aksesin në bibliotekat on-line detyrimet financiare, grantet vendëse apo huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zë të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nga RVB, dhe dokumentaioni plotësues, GVJ konstaton që cdo fillim viti financiar Senati Akademik miraton propozimin e Rektoratit për detajimin e grantit të pushtetit qendror për vitin në vazhdim, dhe ia kalon ato më pas Bordit të Administrimit për miratim. Bordi i Administrimit nga ana e tij miraton detajimin e grantit dhe ngarkon Administratorin dhe Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e tij. Ky plan financimi përfshin kostot për realizimin e programit të studimit, financimin për burimet njerëzore shpenzimet për libra dhe publikime shkencore, mjete didaktike, materiale dhe pajisje laborotrike, etj. Aktualisht plani i financimit hartohet në nivel institucional. Është duke u punuar që në të ardhmen të hartohen plane financimi në rang programi studimi.</p> <p><i>Ref. Nr. 49.1, Mbi procedurën e hartimit dhe miratimit e planit të kostove; Ref. Nr. 49.2, Mbi miratimin e propozimit për detajimin e Art. 602.8, Vendim i Senatit, Nr. 4, datë 10.01.2019; Ref. Nr. 49.2.1, Mbi detajim Art. 602.8, Vendim i Bordit të Administrimit, Nr. 7, datë 31.01.2019; Ref. Nr. 49.2.2, Mbi shtesa në vendimin Nr.3, Vendim i Senatit, Nr. 13, datë 01.03.2019; Ref. Nr. 49.2.3, Mbi shtesa në vendimin Nr. 4, Vendim i Senatit, Nr. 14, datë 01.03.2019; Ref. Nr. 49.2.4, Mbi miratimin e propozimit për detajimin e të ardhurave, Vendim i Senatit, Nr. 15, datë 01.03.2019; Ref. Nr. 49.2.5, Mbi shtesa në vendimin Nr.3, Vendim i Senatit, Nr. 21, datë 10.04.2019; Ref. Nr. 49.2.6, Mbi miratimin e propozimit për shtesa në detajimin e të ardhurave, Vendim i Senatit, Nr. 29, datë 05.07.2019; Ref. Nr.49.2.7, Mbi ndryshime në vendimin 4, Vendim i Senatit, Nr. 36, datë 14.10.2019; Ref. Nr. 49.2.8, Mbi shtesa në vendimin Nr.15, Vendim i Senatit, Nr. 37, datë 14.10.2019;</i></p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Nga RVB, dhe dokumentaioni plotësues, GVJ konstaton që Institucioni harton pasqyra financiare të hollësishme brenda afateve të parashikuara për deklarimin e dorëzimit të pasqyrave financiare. Këto i dërgohen për miratim ministrisë përgjegjëse për arsimin. I gjithë aktiviteti financiar i institucionit, përfshirë edhe pasqyrat financiare, është subjekt auditimi nga ministria përgjegjëse për arsimin. Misioni i auditimit konsiston në auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme, auditimin e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit, auditimin e krijimit dhe menaxhimit të të ardhurave, etj. Konstatojmë se institucioni me marrjen e raportit të auditit merr masa për hartimin e një plan veprimi me qëllim implementimin e rekomandimeve dhe sugjerimeve të grupit të auditit. Raporti i auditit i përcillet edhe Bordit të Administrimit.</p> <p>Në përmbushje të detyrimeve ligjore institucioni dorëzon në mënyrë periodike pasqyrat financiare në nivel institucional, ende jo në nivel programi. Plani financiar i hartuar parashikon diversifikimin e planit të financimit me qëllim që të garantojë vazhdimësinë e ofrimit të programeve të studimit. Si rregull, në mes dhe në fund të një programi studimi, institucioni rishikon koston e një programi studimi, që mund të rezultojë në një ndryshim eventual të financimit. Edhe përballë situatave të paprashikuara, përmes ndërhyrjeve të posaçme, institucioni dëshmon aftësi për garantimin e ecurisë së një programi studimi. Si shembull të kësaj vërejmë reduktimin e tarifës së shkollimit gjatë vitit akademik.</p> <p><i>Ref. Nr. 49, Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional; Ref. Nr. 49.3, Raporti i auditit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Të dhënat financiare të vëna në dispozicion të GVJ, dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				✓

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				✓

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit përkatës, GVJ konstaton se Institucioni ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe rregullores e statutit të institucionit, rregullores së fakultetit dhe rregullores së programit të studimit, të hartuara e të përditësuara vazhdimisht në përputhje të këtij legjislacioni. Institucioni dhe njësia kryesore dhe njësia bazë për ofrimin e programit kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse.</p> <p>Nga konsultimi i dokumentacionit përkatës, GVJ konstaton se Institucioni garanton barazinë dhe të drejtat e njëjta për të gjithë kandidatët për student dhe studentët, duke bërë transparente kriteret dhe procedurat që nga momenti i hyrjes deri në dalje.</p> <p>Nga konsultimi i dokumentacionit përkatës rezulton se kriteret dhe procedurat përkatëse për ofrimin e programit të studimit janë hartuar në mënyrë që të jenë të kuptueshme, dhe njëkohësisht dhe të aksesueshme nga publiku. Nga informacioni i grumbulluar GVJ konstatoi se kriteret dhe procedurat janë të aksesueshme online edhe i bëhen të ditura të interesuarve në zyrën e sekretarisë mësimore në oraret e përcaktuara për sqarime dhe shërbime dhe gjatë këshillimit e orientimit të ofruar nga zyra përgjegjëse për informimin e studentëve në rang fakulteti e institucioni.</p> <p><a href="https://ust.edu.al/master-profesional/">https://ust.edu.al/master-profesional/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Vlerësojmë se duke u bazuar në dokumentat e vënë në dispozicion si dhe nga intervistat me studentët, kriteret dhe procedura e pranimit bëhen publike dhe janë lehtësisht të aksesueshme në faqen ëeb dhe në mjetet e tjera të informimit si shtypi i përditshëm dhe llogaritë në rrjetet sociale etj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionin përkatës rezulton se përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni merr pjesë në fushatat e informimit të organizuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; merr pjesë në aktivitete për promovimin e programit të studimit si dhe zyra e karrierës dhe Dekanati organizojnë takime informuese me studentët e vitit të tretë bachelor me qëllim orientimin dhe promovimin e këtij cikli studimi.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rezultoni se Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin; gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren e brendshme të institucionit. Gjithashtu studentët kanë qasje mbi ecurinë akademike përmes account-it në platformën ESSE3, ku ruhen rekordet akademike ndër vite.</p> <p>Nga vizita në Institucion dhe dokumentacioni mbështetës rezultoni se kriteret dhe procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme i bëhen të ditura studentëve dhe janë pjesë e dokumenteve rregullatore.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës dhe takimeve me studentë konstatoam se Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Rregullorja e institucionit parashikon elementet përbërës të vlerësimit të cilat janë të reflektuara në programet/silabet e lëndëve. Gjithashtu në fillim të vitit akademik, studentëve u vihet në dispozicion programi/silabusi i çdo lënde të programit të studimit.</p> <p>Nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës konstatoam se Institucioni informon rregullisht studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Njësia bazë që mbulon programin e studimit në bashkërendim me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve informon studentët për modalitetet e temës së diplomës dhe Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar. Rregullorja e për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar procesin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogut udhëheqës, etapat e shkrimit të tezës, e deri te formati final për dorëzim dhe mbrojtje.</p>




	<p><i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, Kreu III.</i></p> <p><i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 60, pika 5.</i></p> <p><i>Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 61, pika 7.</i></p> <p><i>Ref.Nr.10. Rregullore e Diplomimit (Kreu II).</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Nga vizita në Institucion dhe dokumentacioni mbështetës rezulton se Institucioni prej disa vitesh tashmë ka marrë pjesë në fushatat e informimit dhe panairove të organizuara me iniciativën e ministrisë përgjegjëse. Grupe me anëtarë të personeli akademik organizojnë takime periodike me studentët e vitit të fundit të nivelit Bachelor për Programin e Master Profesional në Aktiviteti Fizik Rekreacioni-Trajner Fitnesi. Përgjatë ditëve të regjistrimit, njësia kryesore vë në dispozicion të studentave të interesuar për të vazhduar studimet në programin e studimit MP, grupe pedagogësh që japin informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve në UST.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>✓</p>

<p><b>Standardi V.3</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga vizita në Institucion dhe dokumentacioni mbështetës rezulton se Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. Institucioni sigurohet që të vërë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit dhe kohëzgjatjessë programit të studimit.</p> <p>Informimi bëhet në mënyrë të hollësishme përmes këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit, kontakteve me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve, dhe vënies së rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit në dispozicion të studentëve si dhe takimeve informues e orientues për të gjithë studentët për aspektet e programit të studimit.</p> <p>Nga vizita në Institucion dhe dokumentacioni mbështetës rezulton senë faqen zyrtare web bëhen publike informacion për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese si struktura e vitit akademik, informacion përlëndët, veprimtaritë formuese etj. Në llogarime e tyre, ne</p>

	<p>hapsiren didaktikete sistemit ESSE3 studentët aksesojnë strukturën e çdo program studimi që ofrohet me elementet përbëres në lëndë e module dhe kreditet përkatëse.</p> <p>Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion programi/sylabi i të gjitha lëndëve që do të zhvillohen, ku janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar, ngarkesa, temat për çdo javë mësimore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.</p> <p><a href="http://fvfr.ust.edu.al/ep-content/uploads/2019/10/Struktura-mp-trajner.pdf">http://fvfr.ust.edu.al/ep-content/uploads/2019/10/Struktura-mp-trajner.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga vizita në Institucion dhe vlerësimi i dokumentacionit mbështetës rezulton se Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. Orientimi i studentëve drejt tregut të punës, si në rang universiteti nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënive me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni, ashtu si edhe në rang fakultetit përmes Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve.</p> <p>Gjithashtu organizohen takime mes punëdhënësve dhe studentëve, ku vetë punëdhënësit i informojnë studentët për oferta pune. Megjithëse ka përpjekje përmes platformës alumni, ku studentët informohen për oferta pune e trajnimesh të ofruara nga subjektet bashkëpunuese me UST nevojiten masa me konkrete nga Institucioni për ta bërë me funksionale këtë platformë. <i>Ref. Nr. 64, Kalendari i aktiviteteve FVFR 2017-2019.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga vizita në Institucion dhe vlerësimi i dokumentacionit mbështetës rezulton se studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Studentët marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hapësirën respektive të programit të studimit në stedën informuese si dhe monitorët elektronik për njoftimet, në hollin kryesor në hyrje të godinës.</li> <li>- Hapësirën didaktike në platformën online ESSE3</li> </ul> <p>Faqja zyrtare web dhe llogaritë zyrtare në rrjetet sociale të universitetit dhe fakultetit janë një tjetër mjet për përditësimin e informacionit në kohë reale.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Mbas shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës për këtë kriter rezulton se sapo regjistrohen si student të programit të studimeve, këta të fundit pajisen nga zyra e TIK me një llogari personale në platformën ESSE3, nga ku aksesojnë Sistemin e Menaxhimit të Informacionit. Edhe në distancë, përmes platformës studentët mund të aksesojnë të dhënat në lidhje me programin e studimit, si edhe të komunikojnë me mesazhe në formë teksti me pedagogët e lëndëve.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

**Standardi V.4**  
**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë\*, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Mbas shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës për këtë kriter rezulton se Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. Për secilin program studimi, institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me numrin e studentëve të diplomuar dhe cilësinë në dalje.  <i>Ref. Nr. 27, Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje.</i>						
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nga vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatuam se Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Konkludojmë se Institucioni disponon statistika të plota mbi ecurinë e studentëve në secilin program studimi.  Numri i studentëve në këtë program studimi ka qenë në tre vitet e fundit si më poshtë:  <table border="1"> <tr> <td>Viti akademik 2017-2018</td> <td>34 studentë</td> </tr> <tr> <td>Viti akademik 2018-2019</td> <td>23 studentë</td> </tr> <tr> <td>Viti akademik 2019-2020</td> <td>29 studentë</td> </tr> </table> Ky numër studentësh zakonisht vjen nga programi Bsc që ofron ky fakultet.  <i>Ref. Nr. 27, Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje.</i>	Viti akademik 2017-2018	34 studentë	Viti akademik 2018-2019	23 studentë	Viti akademik 2019-2020	29 studentë
Viti akademik 2017-2018	34 studentë						
Viti akademik 2018-2019	23 studentë						
Viti akademik 2019-2020	29 studentë						
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit, deri në diplomimin e tyre.  <b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të	Nga vizita në Institucion dhe vlerësimi i dokumentacionit mbështetës rezulton se Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre. Çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat; nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. Rekordet e studentit ruhen në sistemin elektronik dhe në regjistrat që plotësohen me shkrim. Dega e Informacionit Studentor dhe Regjistrimit është përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave të studentit.  Nga vizita në Institucion dhe vlerësimi i dokumentacionit mbështetës						



<p>sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>rezulton se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit UMIS (pjesë e të cilit është dhe ESSE3), ku mendësohet edhe siguria e të dhënave si dhe aksesit nga personat e autorizuar. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është një sistem informatik funksional dhe efektiv, i cili ruan, administron dhe përpunon të gjitha të dhënat e studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe disa aspekte të tjera në funksion të programit të studimit si financat studentore. Përbajtja e informacioneve/njoftimeve që lidhen me UMIS administrohen nga sektori i TIK, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Mbas shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës për këtë kriter rezulton se Institucioni harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Në fund të vitit kalendarik departamenti përgjegjës për programin e studimit analizon dhe harton një raport analitik mbi arritjen e objektivave formuese të programeve të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe aftësimit profesional, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen. Një kopje e raportit të kësaj analize i përcillet dekanatit, që nga ana e vet i përpunon këto edhe mbi bazën e raporteve të ardhura nga departamentet e tjera, për të hartuar një raport analitik në nivel njësie kryesore. Ky raport shërben si bazë për hartimin e objektivave për vitin pasues. Mbi këtë bazë konkludojmë se kriteri përmbushet plotësisht. <i>Ref. Nr. 38, Model Analize vjetore e Departamentit të Veprimtarive Fizike, Rekreative e Turizmit; Ref. Nr. 38.1, Model Analize vjetore e Fakulteti të FVFR-së.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>✓</p>

<p><b>Standardi V.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës konstatuam se ky kriter plotësohet pasi Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të UST-së. Studentët përfshihen në vendimmarrjen e universitetit, përmes përfaqësimit të tyre në organet drejtuese të institucionit dhe në strukturat mësimore-kërkimore.</p>

	<p>Më kryesoret përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Këshilli i Studentëve në rang njësie kryesore dhe univeriteti</li> <li>▪ Senati Akademi</li> <li>▪ Këshilli Etikës</li> <li>▪ NJSBC</li> </ul> <p><i>Ref. Nr. 2, Statuti i Universitetit të Sporteve, neni 10, pika 2, neni 12 pika 2, neni 29, pika 2, neni 31, pika 1.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës GVJ konstatoi se UST garanton se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik është reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. Përpara përfundimit të semestrit studentët bëjnë vlerësimin të programit të studimit në bazë lënde, përmes pyetësorit që plotësojnë, i cili garanton anonimin e studentëve. Instrumenta të tjerë janë dhe “Focus Group”-et dhe intervistatet gjysmë të strukturuar, me grupe studentësh të programeve përkatëse, për të trajtuar shqetësimet dhe pritshmëritë e tyre.</p> <p>Gjithashtu, Departamenti përgjegjës për programin e studimit merr masa që një anëtar student të bëjë pjesë në grupin e punës për rishikimin e programeve/silabeve të lëndëve. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Një student i programit MP është pjesë e GVB-së të ngritur në kuadër të hartimit të këtij raporti. Gjithashtu një student i MP është pjesë e NJSBC.</p> <p>Sugjerojmë realizimin e anketimeve të posacme për cdo lëndë apo pedagog me qëllim evidentimin më të hollësishëm e problematikave pasi aktualisht pyetësorët nuk ofrohen për cdo lëndë apo cdo pedagog.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin si dhe takimet me studentët GVJ konstatoi se programet e studimit i nënshtrohen në mënyrë periodike rishikimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesës së shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra. Kriteret dhe procedurat që ndiqen për studentët që duan të transferojnë studimet e tyre në UST janë të parashikuara në dokumentet rregullatorë të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin si dhe takimet me studentët konstatoam se UST garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>

<p>programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes Pyetësorit me studentët, fokus grupeve. Pyetësi organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit. Ndër elementët që vlerësohet është edhe syllabusi i lëndës.</p> <p>Takimet këshilluese të studentëve me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve, në disa raste edhe në praninë e koordinatorit të programit. Gjetjet e tyre, bëhen pjesë e diskutimeve, raporteve analitike semestrale e vjetore, dhe mund të shoqërohen me ndryshime në programin e studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin si dhe takimet me studentët GVJ konstatoi se studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme dhe pasqyrohet në programin/silabusin e secilës lëndë. Tezat e sekretuara, shpjegimet e pedagogut për vlerësimin, rishikimi i tezës dhe çelësit të përgjigjeve, dhe mundësia për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashhtrojnë kërkesat e tyre duke ndjekur procedurat e parashikuara në rregulloren e institucionit. Sugjerojmë realizimin e anketimeve të posacme për cdo lëndë apo pedagog me qëllim evidentimin e problematikave.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>✓</p>

<p><b>Standardi V.6</b></p> <p><b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin,</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin përkatës rezulton se Institucioni siguron informim, këshillim e orientim për studentët e të gjithë programeve dhe të gjithë cikleve të studimit, si në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore.</p> <p>Vlerësojmë se Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Rezulton se Koordinimi</p>

<p>ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>i aktivitetit të zyrave të këshillimit në rang fakulteti me aktivitetin e zyrës në nivel institucioni për asistencës së vazhdueshme ndaj studentëve, madje edhe pas përfundimit të studimeve janë në një nivel të kënaqshëm.</p> <p>Vlerësojme se Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Rezuton se Koordinimi i aktivitetit të zyrave të këshillimit në rang fakulteti me aktivitetin e zyrës në nivel institucioni për asistencës së vazhdueshme ndaj studentëve, madje edhe pas përfundimit të studimeve janë në një nivel të kënaqshëm.</p> <p>Nga konsultimi me dokumentacionin si takimet përkatëse konstatoam se Drejtoria e Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni mban kontakte me studentët e diplomuar dhe është duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UST, pjesëmarrje në trajnime pasuniversitare, apo edhe oferta arsimimi në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit përmes platformës <a href="http://alumni.ust.edu.al/">http://alumni.ust.edu.al/</a>. Sugjerojme se Instucioni duhet të marre masa më konkrete për ta bërë me efektive përdorimin e platformës <a href="http://alumni.ust.edu.al/">http://alumni.ust.edu.al/</a>.</p> <p><i>Ref. Nr. 32, Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale.</i></p> <p><i>Ref. Nr. 29, Të dhëna Tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				✓

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				✓

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<p><b>Standardi VI.1</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p>
--

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentave të vëna në dispozicion nga UST vihet re se Institucioni i kushton vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë, për të garantuar që veprimtaria e tij jonetëm është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore, duke përdorur mekanizma të sigurimit të cilësisë nëdisa aspekte.</p> <p>Vlerësojmë se Institucioni ka të ngritur dhe e ka bërë funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë si dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe si dhe ka angazhuar bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Në përbërje të NJSBC janë 3 pedagogë dhe 2 studentë, si dhe janë angazhuar 2 eksperte. Në grupet e punës për Sigurimit të Cilësisë në njësinë bazë rezultojnë se janë të angazhuar edhe studentë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit ,fillimisht në formën e grupeve dhe komisioneve <i>ad hoc</i>, dhe që nga mars 2018 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin dhe produktivitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore shkencore të UST-së. NJSBC ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit dhe kryen kontrole në bazë të strategjisë së UST-së 2017-2020 dhe Planit të Veprimit të Senatit Akademik. Ngritja e organeve drejtuese, sikurse dhe angazhimi në NJSBC i ekspertëve të jashtëm, i përgjigjet gjithashtu nevojës së institucionit për t’u konsultuar me aktorë të jashtëm. Në përbërjen e NJSBC jane 3 anëtarë të stafit akademik (Kryetari dhe 2 përfaqësues të fakulteteve), dhe 2 studentë; ku aktualisht si përfaqësues i FVFR-së është një anëtar staf akademik dhe 1 student. Për të mbështetur objektivat e sigurimit të cilësisë pranë Departamentit të VFRT është ngritur grupi i punës për sigurimin e cilësisë së programit të studimit në të cilën përfshihen 3 pedagogë dhe një student, ky i fundit i propozuar nga Këshilli Studentor.</p> <p><i>Ref. Nr. 37.1, Plani i Veprimit të Senatit; Ref. Nr. 37.2, Vendimi i Ngritjes së NJSBC; Ref. Nr. 56, “Mbi ngritjen e grupit të punës për sigurimin e cilësisë së brendshme në programin e studimit MP”, Vendim nr. 1/1, datë 10.15.2018, Nr. Prot 45/2.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentave të vëna në dispozicion nga UST dhe vizita në Institucion vihet re se Sigurimi i cilësisë realizohet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Monitorimit nga ana e strukturave drejtuese</li> <li>- Tërheqjes së mendimit të studentëve me metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta,</li> <li>- bashkëpunimit me partnerët,</li> <li>- bashkëpunimin me subjekte të Tregut të Punës,</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- si edhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore e duke iu nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme,</li> <li>- zbatimit të rekomandimeve të lidhura me akreditimin e pare institucional,</li> <li>- auditimeve të ushtruara nga MASR, auditimet periodike nga MASR mbi punën mësimore shkencore dhe financiare;</li> <li>- vizitave periodike monitoruese të MASR mbi kapacitetet akademike dhe infrastrukturore në funksion të miratimit të kuotave për çdo vit akademik etj.</li> </ul> <p><i>Ref. Nr. 37.1, Plani i Veprimit të Senatit; Ref. Nr. 49.3, Raporti i auditit.</i></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës GVJ konstatoi se Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron përmes analizave vjetore, si dhe relacionet periodike, të cilat tregojnë për një bashkërendim të punëve midis personelit dhe përfshirjes së studenteve. Punonjësit realizojnë detyrat në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe rregulloret e brendshme të UST, FVFR si dhe rregulloren e programit të studimit duke garantuar rigorozitet në evidentimin e problemeve dhe efikasitet në zgjidhjen e tyre.</p> <p>Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendarik të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse dhe rregullores së kësaj njësie.</p> <p><i>Ref. 37.3 Plan Veprimi i Kalendarik i NJSBC; Ref. Nr. 37, Raporte mujore të NJSBC, periudha mars 2018-maj 2019; Ref. Nr. 8, Rregullore e NJSBC.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <td style="background-color: red; color: white;">Nuk përmbushet</td> <td style="background-color: orange;">Përmbushet pjesërisht</td> <td style="background-color: yellow;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="background-color: green;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="font-size: 2em;">✓</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				✓
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			✓						

<p><b>Standardi VI.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ mbas konsultimit me domentacionin përkatës dhe vizitës në Institucion arriti në përfundimin se UST ka të ngritur dhe funksional të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. Po listojmë si me poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e NJSBC-ja, e cila vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit.</li> <li>• Njësia bazë, ku përgjegjësit e lëndëve/modulit, koordinatori i programit si dhe grupet e punës që ngrihen për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve luajnë një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim. Njësia bazë merr masa për zbatimin e detyrave sipas përcaktimeve në Statut dhe detajimeve në dokumentat e tjera rregullatorë.</li> <li>• Takimet me përfaqësues nga tregu i punës kanë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm pasi reflektojnë dinamikat dhe kërkesat që vijnë nga tregu (që merren gjate zbatimit të praktikës profesionale dhe programeve “outdoors” dhe workshop-eve).</li> <li>• Në takime me student bëhen diskutime të hapura mbi aspekte që lidhen me monitorimin dhe rishikimin e programit MP.</li> </ul> <p>Rekomandimet nga aktorët e përfshirë shërbejnë si bazë për ndryshime në kurrikula nëf unksion të përshtatjes sa më mire me këto kërkesa.</p> <p><i>Ref. Nr. 2, Statuti i Universitetit të Sporteve, neni 22, pika 3; Ref. 12.1, Relacion i aktivitetit të zyrës së karrierës, Ref. Nr. 52, Relacion mbi ndryshimet në planet mësimore, Nr. Prot. 689, datë 27.04.2018.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ mbas konsultimit me domentacionin përkatës në lidhje me këtë kriter konstaoi se UST përgatit dhe shpërndan në formën e një analize vjetore vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturavedrejtuese, por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/ prezantimit në nivel departamenti, diskutimit/ prezantimit në nivel fakulteti dhe në nivel rektorati.</p> <p><i>Ref. Nr. 37.4, Përcjellje raporti vjetor për vitin 2018.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ vlerëson se Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. Raportet mbi aktivitetet me karakter kontrollues, monitories dhe vlerësues që organizohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në nivel universiteti dhe grupi i punës i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Programit MP “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi”, grupi i punës për Ndryshimet në Kurrikulën e programit MP raportohen pranë departamentit dhe dekanatit të FVFR. Mbi këtë bazë njësia bazë dhe njësia kryesore organizojnë mbledhje të posacme për të diskutuar mbi rekomandimet dhe gjetjet e raporteve. Zbatimi i detyrave që lidhen me garantimin e cilësisë së programit të studimit ndiqen nga ana e strukturave drejtuese.</p>

	<i>Ref. Nr. 37, Raporte mujore të NJSBC, periudha mars 2018-maj 2019, Ref. Nr. 56.1, Raport vjetor i grupit të punës për sigurimin e cilësisë në programin e studimit, datë 22.10.2019, nr. Prot. 75/1, Ref. Nr. 52, Relacion mbi ndryshimet në planet mësimore, Nr. Prot. 689, datë 27.04.2018.</i>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit hartohen në formë raporti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse përgjegjësit të departamentit, stafit akademik etj.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës rezulton se raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë.</p> <p>NJSBC, grupi i sigurimit të cilësisë në programin e studimit MP “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi”, Zyra e Kurrikulës si dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të problematikave apo mangësive.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës përkates që lidhet me këtë kriter rezulton se vlerësimi nga NJSBC bëhet në nivelin institucional (3 anëtarë nga stafi akademik dhe 2 studentë) dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme, Departamenti VFRT përgjegjës për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programin MP “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi”.</p> <p>Në vijim të raporteve dhe rekomandimeve të NJSBC realizohen dhe relacione nga grupi i punës në nivel Departamenti për sigurimin e brendshëm të cilësisë të programit të studimit, si dhe realizohen analiza periodike të punës mesimore dhe kërkimore shkencoreduke siguruar informacione të vlefshme për vetëvlerësimin në kuadër të akreditimit institucional dhe programit të studimit.</p> <p><i>Ref. Nr. 56, Mbi ngritjen e grupit të punës për sigurimin e cilësisë së brendshme në programin e studimit BA, Vendim nr. 1/1, datë 10.15.2018, nr. Prot 45/2; Ref. Nr. 56.1, Raport vjetor i grupit të punës për sigurimin e cilësisë në programin e studimit, datë 22.10.2019, nr. Prot. 75/1.</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Nga konsultimi dhe vlerësimi i dokumtacionit vihet re se UST për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta duke përdorur instrumente efikase dhe të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës së Veprimtarisë Fizike, Shëndetit dhe Rekreacionit me synim plotësimin e objektivave të programit të studimit. Disa prej metodave që UST përdor për kryerjen e vlerësimeve përfshijnë: monitorimi dhe kontrolli i elementëve të lidhur me proceset akademike të mësimdhënies/ mësimnxënies si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mbarëvajtja e provimeve, program/syllabus-et,</li> <li>- literature e përdorur,</li> <li>- infrastruktura TIK,</li> <li>- ambientet sportive etj.</li> </ul> <p>Instrumentet të tjera që përdoren për përfshirjen e studentëve janë perms pyetësorëve, fokusgrupet, prezantimet orientuese/diskutimet me studentët, mbledhje te hapura mbi aspekte të caktuara të programit të studimitetj.</p> <p>Sugjerojmë krahas anketimeve aktuale të realizohen edhe sondazheve në mënyrë më të personalizuar për secilin lëndë/modul, vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve për secilin pedagog dhe anëtar të stafit administrativ strukturat drejtuese të UST-së duhet të ndërmarrin iniciativa për ndërgjegjësimin e stafit dhe studentëve me synim realizimin e një procesi vlerësimi më të detajuar e transparent por që respekton të drejtat dhe konfidencialitetin e palëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga konsultimi dhe vlerësimi i dokumtacionit përkatës rezultoi se UST, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës. UST, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Teste të standardizuara Teorike</li> <li>- Teste të standardizuara Praktike</li> <li>- Dëgjime në auditor;</li> <li>- Vlerësimi me pikë;</li> <li>- Testimete ndërmjetëm dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi i punëve në grup/ detyrave/ projekteve të kryera nga studentët;</li> <li>- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës</li> </ul> <p>Nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës konstatoam se për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vizita nga eprori (Përgjegjësi Njësisë bazë/ Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky process përfundon me këshillime individuale me Përgjegjësin e Departamentit dhe mund të diskutohet në mbledhje të posaçme duke respektuar të drejtat dhe etikën akademike në varësi të problematikës.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Nga vizita në Institucion dhe vlerësimi i dokumentacionit përkatës konstatoam se, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit UST përdor metoda e instrumente të tërthorta. Metodat dhe Instrumente të tërthorta që përdoren kryesisht përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Sondazhe/Anketime: të studentëve që ndjekin programe te studimeve,</li> <li>– Fokus Grupe me Studentë</li> <li>– Intervista Inviduale/ në Grup</li> <li>– Diskutime të hapura</li> <li>– Takime dhe tërheqje mendimi nga studentët alumni</li> <li>– Takime dhe tërheqje mendimi nga përfaqësues të Tregut të Punës</li> <li>– Studime Kombëtare dhe analiza për Tregun e Punës</li> </ul> <p>Rezultatet e vlerësimeve të studentëve i vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në analizën e punës mësimore shkencore vjetore në përfundim të vitit akademik. Mbi këtë bazë konkludojme se UST kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative perms metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, që ndjekin programin e studenteve.</p> <p><i>Ref. Nr. 12.1, Relacion i aktivitetit të zyrës së karrierës.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>✓</p>

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në Institucion dhe vlerësimi i dokumentacionit përkatës GJV konstatoi se Institucioni duhet ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedurat e brendshme të cilësisë për përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Përmendim si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëveshjet e bashkëpunimit me Institucione Partnere</li> <li>- Marrëveshjet e bashkëpunimit nga fushës se biznesit</li> <li>- Marrëveshjet e bashkëpunimit me Institucione shtetërore që operojnë në sektor</li> <li>- Angazhimi në NJSBC ekspertëve të jashtëm</li> </ul> <p>Të gjithë këta faktore i përgjigjen gjithashtu nevojës së institucionit për t'u konsultuar me aktorët brendshëm e jashtëm. Konkludojme se aspektet positive të përfshirjes me aktorë të brendshëm e jashtëm bazohen nëshkëmbimnepërvojave, njohjen me qasje novatore, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit të përmendura në kritere te mësipërme.</p> <p>Në planin e veprimit të Senatit Akademik per sigurimin e brendshëm të cilësisë për caktohen detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve të angazhuar. Në përbërjen e NJSBC (në nivelin Institucional) janë 3 anëtarë të stafit akademik dhe 2 studentë. Në strukturën e grupit të punës për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, të ngritur pranë njësisë bazë, që mbulon programin e studimit bëjnë pjesë 3 pedagogë dhe një përfaqësues i studentëve, i propozuar nga Këshilli i Studentëve.</p> <p><i>Ref. Nr. 34, Lista e subjekteve bashkëpunuese në nivel IAL-je dhe me institucione të tjera të UST-së .</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit përkatës dhe vizita në Institucion rezulton se përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe se Institucioni ka marrë masa për të shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Nga konsultimi i dokumentacionit përkatës mbi këtë kriter rezultoi se :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Angazhimi i ekspertëve të jashtëm në strukturën e NJSBC-së</li> <li>- Takimet me përfaqësues nga Tregu i Punës/ Institucione shtetërore</li> </ul>

<p>jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Pjesëmarrja në projekte shkencore që synojnë përmirësimin e cilësisë</li> <li>– Shkëmbimi i eksperiencës me partnerët ndërkombëtare</li> </ul> <p>Janë tregues të angazhimit të aktorëve të jashtëm në procese të lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Ref. Nr. 30.1, Vendim i Senatit mbi Përcaktimin e Konsulentëve të Jashtëm, Nr. 17, datë 27.02.2018; Ref. Nr. 35, Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve, Ref. Nr. 64, Kalendari i aktiviteteve FVFR për vitet 2017-2019.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
<p>✓</p>				

<p><b>Standardi VI.5</b></p> <p><b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nga vizita në UST dhe vlerësimi i dokumentacionit përkatës GVJ konstatoi se UST ka hartuar dhe ndjekur politika, strategji, dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, të cilat janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një plani të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me rezultatet përkatëse.</p> <p>Nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës rezultojnë se raportet e NJSBC-së, Analizat periodike, Raportet/Analizat e punës mësimore dhe kërkimore shkencore dhe financiare në tërësi i shpërndahet drejtuesve dhe nënjesite baze diskutojnë vetëm ato pjesë të raporteve që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me atë njësi. Në çdo rast nga të dhënat e vëna në dispozicion rezultojnë se publikimet mbi rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit monitorohen nga përfaqësuesi i Komisionerit për të dhënat personale. Megjithatë NJSBC ka planifikuar pilotimin e pyetësorëve edhe në mënyrë të personalizuar dhe më të detajuar për secilin lëndë/ modul/ pedagog për vitin akademik aktual por ende nuk është realizuar një nismë e tillë sugjerojmë realizimin e një anketimi të tillë; paraprakisht është e nevojshme marrja e masave institucionale për të përdorur një proces transparent por që njëkohësisht respekton konfidencialitetin si dhe garanton të drejtat e palëve.</p>

	<i>Ref. Nr. 48, Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale; Ref. Nr. 48.1, Politikat e Privatësisë; Ref. Nr. 5, Rregullore e Universitetit të Sporteve të Tiranës, neni 16, pika 2.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin përkatës dhe takimet në Institucion vihet re se rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. GVJ vlerëson se të dhënat e përftuara nga vetëvlerësimet periodike kanë shërbyer jo vetëm për analizimin e situates por edhe për identifikimin e problematikave me synim marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brendshme.</p> <p>Në bazë të natyrës së problematikave të evidentuara nëpërmjet analizave, janë marrë masa, të cilat variojnë nga zhvillimi i seminareve orientuese/ trajnuese dhe deri tek masat konkrete përzgjidhjen e problematikave të evidentuara.</p> <p>Megjithëse NJSBC ka planifikuar pilotimin e pyetësorëve edhe në mënyrë më të personalizuar dhe më të detajuar për secilin lëndë/ modul/ pedagog për vitin akademik aktual por ende nuk është realizuar një nismë e tillë sugjerojmë realizimin e një anketimi të tillë krahas pyetësorëve aktualë.</p> <p><i>Ref. Nr. 37.3, Plan Veprimi i Kalendarik i NJSBC.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>GVJ vlerëson se të gjithë dokumentet e vëna në dispozicion, procedurat dhe instrumentet e përmendura në kriteret e mësipërme dëshmojnë faktin se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Nga konsultimi me dokumentacionin përkatës dhe takimet në Institucion vihet re se Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Zbatimi i planit të punës në përputhje me rregulloren e programi të studimit MP “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi”, rregullore, planit vjetor të FVFR-së,dhe planit të veprimit të NJSBC për arritjen e synimeve si dhe klima sociale e bashkëpunues midis stafit akademik, personelit administrativ dhe studentëve evidentojnë e nxisin marrëdhënie të frytshme midis tyre .</p> <p><i>Ref. Nr. 3, Plani Strategjik UST 2017-2020, Objektivat, f.5; Ref. Nr. 37.3, Plan Veprimi i Kalendarik i NJSBC; Ref. Nr. 38.1, Model Analize vjetore e Fakulteti të FVFR-së.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Aktivitet Fizik dhe Rekreacioni-Trajner-Fitnesi”, “ Universiteti i Sporteve të Tiranës ”.**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Cilësia e stafit. Nëpërmjet një personeli të kualifikuar mësimdhënës, drejtues, administrativ e mbështetës synohet garantimi i një shërbimi cilësor bashkëkohor ndaj studentëve nga të gjitha njësitë përbërëse
2. Marrëdhënie bashkëpunuese me:
  - tregun e punës me subjekte publike dhe jopublike që janë të lidhura drejtpërdrejtë me fushën e programit të studimit e që i kontribuojnë cilësisë së praktikave profesionale të studentëve.
  - me tregun e punës dhe lidhje efektive me subjekte publike dhe jopublike duke shtuar mundësitë e trajnimit, stazhit, punësimit të studentëve.
  - me institucione të ngjashme në Europë e më gjerë si Itali, Rumani, Kroaci, Greqi, etj
3. Unifikimi i programit mësimor të fakultetit me fakultete të tjera në Europë, e më gjerë, e cila bën të mundur punësimin e studentëve pas mbarimit të studimeve.
4. Aftësi profesionale gjatë ndjekjes së lëndëve me karakter praktik e profesional, si Sporte në Natyrë, e ndarë në modulet Sporte dimërore-Ski, Sporte ujore-Not, dhe lënda Turizëm me modulën Kamping Veror (malor-bregdetar). Lëndët janë ndërtuar me synimin për t'i aftësuar studentët për zgjidhjen e problemeve specifike të fushës përmes aplikimit në praktikë të njohurive teorike, kjo e konstatuar edhe nga intervistat me studentët.
5. Infrastruktura në drejtim të ambienteve të punës, terreneve sportive, infrastrukturës TIK, hapësirave didaktike (auditore, laboratore, biblioteka, laboratore) që ka impakt të drejtpërdrejtë e pozitiv në drejtim të arritjeve sa më plotësisht të objektivave të mësimdhënies e mësimnxënies.

**Pika të dobta që GVB ka nxjerrë në Raportin e vlerësimit të brendshëm:**

1. Gjurmimi i studentëve të punësuar nuk është plotësisht i besueshëm, pasi mundësohet vetëm përmes kontakteve që institucioni mban me subjektet bashkëpunuese dhe vetëdeklarimet e studentëve. Duke qenë se studentët e FVFR-së kanë treg pune kryesor sektorin privat, mungesa e profesionit të rregulluar me ligj “Trajner Fitnesi” ndikon në informalitetin e këtij tregu pune, e për rrjedhojë e kthen atë në një treg pune statitikiisht të pagjurmueshëm nga instancat përkatëse.

2. Përqindja e ulët e mobilitetit të studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ, që do të mundësonte përditësimin me qasjet më bashkëkohore në drejtim të veprimtarisë kërkimore-shkencore, dhe veprimtarisë administrative në funksion të institucionit.
3. Angazhim i ulët për të ofruar shërbime për komunitetin përmes pjesëmarrjes së studentëve në formën e intershipeve.

### **Pika të tjera të dobta që nxjerr GVJ:**

4. Rregullorja e programit të studimit e papërshtatur me ligjin e ri të arsimit të lartë.
5. Syllabuset e lëndëve për vitin akademik 2019-2020 nuk i kanë të pasqyruar elementin e vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve (ndërkohë që të viteve më përpara I kanë shumë të detajuara); pavarësisht kësaj në sekretarinë mësimore u konstatua që të gjithë pedagogët i vlerësojnë studentët edhe gjatë vitit
6. Kontrata të posacme për praktikat profesionale ku studentët mund të angazhohen në stazh të mirëfilltë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Rekomandime:**

1. Në mungesë të një marrëveshje kontraktuale, procesi i praktikës profesionale rregullohet prej rregullores së institucionit. Konstatohet se ka nevojë që kjo marrëdhënie të jetë e formalizuar me kontrata ligjore, me qëllim që të garantohet një proces cilësor i praktikës profesionale.
2. GVJ sugjeron që të punohet me grupet e interesit për të krijuar Urdherin e Profesionit Trajner Fitness
3. Për arsye se të rekrutimit edhe të studentëve të huaj në këtë program studimi GVJ rekomandon që për rekrutimin e pedagogëve ti jepet më shumë % gjuhës se huaj.
4. Për arsye se programi i studimit realizohet pasdite (14:00-20:00), rekomandohet të merren masa edhe për ofrimin e shërbimeve lehtësuese jasht orarit zyrtar, si psh shërbimi i bibliotekës.
5. GVJ sugjeron që procesi i studimit të tregut të marrë trajta edhe më formale, dhe database i të dhënave të pasurohet e të përditësohet, sidomos me informacionet e të diplomuarve të punësuar në sektorin privat.
6. GVJ sugjeron rishikimin e menjëhershëm të Rregullores së programit duke qënë se është e vitit 2013, duke e përshtatur dhe përditësuar me ligjin e ri të arsimit të lartë, si dhe riformatimin e syllabuseve të lëndëve duke pasqyruar vlerësimin në vazhdim të studentëve.

## **Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Professional Master “Physical Activity and Recreation-Trainer-Fitness”, “Tirana University of Sports”.**

### **Strengths and affirmations:**

1. Quality of staff. A qualified teaching, management, administrative and support staff aims to ensure a quality contemporary student service from all constituent units.
2. Collaborative relationship with:
  - the labor market with public and non-public subjects that are directly related to the field of study program that contribute to the quality of students’ professional practices.
  - with the labor market and effective links with public and non-public entities by enhancing training, internship, student employment opportunities.
  - with similar institutions in Europe and beyond such as Italy, Romania, Croatia, Greece, etc.
3. Unification of the curriculum of the faculty with other faculties in Europe and beyond, which enables the employment of students after graduation.
4. Professional skills in the pursuit of practical and professional subjects, such as Outdoor Sports, divided into Winter-Ski Modules, Water-Swimming Modules, and Tourism with Summer Camping Module. The courses are designed with the aim of empowering students to solve specific field problems through the application of theoretical knowledge to practice, as evidenced by interviews with students.
5. Infrastructure in terms of work environments, playgrounds, ICT infrastructure, didactic spaces (auditoriums, laboratories, libraries, laboratories) that have a direct and positive impact on the achievement of the teaching and learning objectives as fully as possible.

### **Weaknesses evidenced by the Internal Evaluation Group according to its internal evaluation report:**

1. The tracking of employed students is not completely reliable, as it is only possible through the contacts the institution maintains with the cooperating entities and the student self-statements. As FVFR students have a primary job market in the private sector, the lack of a regulated profession of “Fitness Trainer” affects the informality of this job market, and consequently turns it into a statistically untraceable job market by the relevant authorities.
2. Low percentage of mobility of students, academic and administrative staff, which would enable updating with the most contemporary approaches to scientific research and administrative activity in the functioning of the institution.
3. Low commitment to provide services to the community through student participation in the form of internships.



### **Further weak points identified by the External Evaluation Group:**

4. Regulation of study program not in line with the new law on higher education.
5. The subject syllabuses for the academic year 2019-2020 do not reflect the element of continuous student assessment (while they were very detailed years ago); however, in the teaching secretariat it was found that all lecturers evaluate students even during the year.
6. Special contracts for professional internships where students can engage in genuine internships in accordance with the legislation in force.

### **Recommendations:**

1. In the absence of a contractual agreement, the process of professional practice shall be governed by the rules of the institution. We conclude that this relationship needs to be formalized by legal contracts in order to guarantee a quality professional practice process.
2. The External Evaluation Group suggests working with stakeholders to create the Order of Fitness Trainer Profession.
3. Because of the recruitment of foreign students in this study program, the External Evaluation Group recommends that more percentage should be given to foreign languages for recruitment of the teaching staff.
4. Because the study program is carried out in the afternoon (14:00-20:00), it is recommended to take measures for the provision of supportive and facilitation services beyond the official schedule, such as the library service.
5. The External Evaluation Group suggests that the market study process take on even more formal forms, and that the database be enriched and updated, especially with the information of graduates employed in the private sector.
6. The External Evaluation Group suggests an immediate revision of the Program Regulation as of 2013, adapting and updating it to the new higher education law, as well as the reformatting of subject syllabuses reflecting an on-going assessment process of the students.



## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				✓
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				✓
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				✓
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				✓
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				✓